

RAPORTI VJETOR 2019

SCAAK

SCAAK

SCAAK



RAPORTI VJETOR 2019

MISIONI

Të fuqizojmë profesionin e kontabilitetit dhe auditimit [në sektorin privat dhe publik] në Kosovë dhe regjion duke promovuar standardet më të larta të etikës, edukimit, dhe ekselencës profesionale për të mirën e shoqërisë si përfitues i fundit.

VIZIONI

Shoqatë lidere në avancimin e profesionit të kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera të specializuara duke ofruar gjithmonë zgjedhjen më të mirë për profesionistët.

QELLIMI

Zhvillimi i vazhdueshëm i programit të trajnimit i krahasueshëm me programet e shoqatave profesionale më eminente të kontabilitetit. Zhvillimi dhe avancimi i bazës së anëtarësisë të njohur për ekspertizë profesionale dhe standarde të larta etike. Anëtarësimi në organizata profesionale ndërkombëtare.

Anëtare me të drejta të plota në:



SCAAK

QENDËR E EKSELENCËS PËR KONTABILITET DHE AUDITIM

Që nga themelimi i saj në vitin 2001, Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK) është zhvilluar në një nga organizatat profesionale lidere të kontabilitetit dhe auditimit në regjion. Përgjatë historisë së saj të zhvillimit, ShKÇAK ka treguar një përkushtim të pakrahasueshëm në edukimin e gjeneratave të tëra të profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit duke fuqizuar transparencën dhe llogaridhënien financiare përmes promovimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, raportimit financiar dhe auditimit.

Sot, ShKÇAK përfaqëson mbi 7,000 profesionistë që janë të angazhuar në një mori të bizneseve në industri të ndryshme, firma të kontabilitetit dhe auditimit, dhe në institucione kyçe të Republikës së Kosovës si Zyra e Kryeministrit, Ministritë, Banka Qendrore e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, Administrata Tatimore e Kosovës, Doganat e Kosovës, Komunitat dhe të tjera.

Njohjet reciproke të thirrjeve profesionale të ShKÇAK nga organizata lidere në nivel ndërkombëtarë si Shoqata e Auditorëve të Çertifikuar në Angli (ACCA), Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar në Angli (AAT) dhe Instituti i Licencuar për Financa Publike dhe Kontabilitet dhe Auditim në Britani të Madhe (CIPFA), përveç që konfirmojnë cilësinë e programeve certifikuese të Shoqatës, i'u mundësojnë anëtarëve të saj t'i qasen edhe tregut ndërkombëtarë të punës. ShKÇAK është e vetmja shoqatë nga Kosova e cila është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK), Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) dhe Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM). Shoqata është integruar tutje në strukturat e këtyre organizatave ndërkombëtare duke qenë e përfaqësuar edhe në Komisionin për Zhvillimin e Organizatave Profesionale (PAODC) të FNK, Panelin Këshillues mbi Pajtueshmërinë të FNK, Forumin Ndërkombëtar të Drejtorëve të Edukimit në Kontabilitet dhe Auditim, Grupin e Ekspertëve të Kontabilitetit dhe Grupin e Ekspertëve të Auditimit të EFAA.

TABLE OF CONTENTS

FJALA E KRYETARES	08
MESAZH NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE	10
1. AKTIVITETET E SHKÇAK GJATE VITIT 2019	12
2. PROGRAME ÇERTIFIKUESE TË BARASVLEFSHME ME NIVELET MË TË LARTA BOTËRORE	29
3. PËRPJËKJE TË VAZHDUESHME PËR OFRIMIN E VLERËS SË SHTUAR PËR ANËTARËT	33
4. PAJTUESHMËRIA ME STANDARDE PROFESIONALE PËRMES MENAXHIMIT TË CILËSISË	35
5. SHKÇAK LUAN ROL AKTIV NË ZHVILLIMET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	37
RAPORTET E KOMISIONEVE	57
STATISTIKAT E VITIT 2019	68
PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR 31 DHJETOR 2019	73

SHKURTESAT

AAT	Shoqata e Teknikëve të Kontabilitetit të Britanisë së Madhe
ACCA	Shoqata e Auditorëve të Çertifikuar të Anglisë
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CAP	Paneli Këshillues mbi Pajtueshmërinë e FNK
CIPFA	Instituti e Licencuar për Financa Publike, Kontabilitet dhe Auditim
DOA (SMO)	Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë të FNK
EFAA	Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM
FCM	Federata e Kontabilistëve të Mesdheut
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
KKRF	Këshilli Kosovar për Raportim Financiar
MF	Ministria e Financave
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OEAK	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
PAODC	Komisioni i FNK për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit
PVM	Praktikat e Vogla dhe të Mesme
QRRF	Qendra për Reforma në Raportim Financiar
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNE	Standardet Ndërkombëtare të Edukimit
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
ShKÇAK	Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

FJALA E KRYETARES



AFËRDITA GASHI

Kryetare e Këshillit

Të nderuar Anëtarë,

Kam kënaqësinë të i'u dëshiroj mirëseardhje të gjithë anëtarëve të rinj që kanë fituar thirrje profesionale gjatë vitit 2019. Në të njëjtën kohë, dëshiroj të përgëzoj të gjithë anëtarët për arritjet e tyre gjatë vitit që lam pas, përkundër sfidave dhe pengesave të cilat shpeshherë i hasim në Kosovë.

Viti 2019 ka filluar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-032 për "Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim" i cili ka sjellë një sërë ndryshimesh në ushtrimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit duke fuqizuar rolin e kontabilistëve të çertifikuar dhe duke zgjeruar shërbimet e

ofruara nga Auditorët Ligjorë. Rrethanat e reja ligjore kërkojnë nënshkrimin e kontabilistit të çertifikuar në pasqyrat financiare gjë që sjell edhe më shumë përgjegjësi për këtë profesion dhe e bën edhe më kritike pajtueshmërinë me Kodin Etik.

Një ndër vlerat më të mëdha të Shoqatës është reputacioni ynë për profesionalizëm, integritet dhe parime të pathyeshme të etikës. Jam e bindur që secili prej jush do të vazhdoni të ruani këtë reputacion me po aq përkushtim sa është dashur për ta fituar atë.

Ambienti vazhdimisht i ndryshueshëm në të cilin veprimtari kërkon që Shoqata dhe të gjithë ne të kemi qasje pro aktive si gjatë proceseve të ligjvënies përmes komenteve tona në projekt ligje, ashtu edhe përmes adoptimit të teknologjive të reja që ndikojnë në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit. Ndryshimet që po ndodhin kërkojnë që profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit të kenë aftësi të reja teknike dhe të jenë më efikas dhe inovativ. Në këtë aspekt, edukimi i vazhdueshëm profesional është një mënyrë shumë e mirë për të mbajtur njohuritë tona të përditësuara me zhvillimet e fundit dhe për të mbetur konkurrues në tregun e punës.

Zëri i ynë si Shoqatë mbetet i fuqishëm si brenda vendit ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.

Gjatë këtij mandati si Kryetare e Këshillit të ShKÇAK kam përfaqësuar Shoqatën në disa takime të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK), Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) dhe Federatës mesdhetare të Kontabilistëve (FCM). ShKÇAK përherë e më shumë po bëhet pjesë e strukturave të këtyre organizatave ndërkombëtare dhe po merret si shembull i mirë i zhvillimit të një organizate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në një vend në tranzicion.

Në fund, dua të ju falënderoj për punën tuaj që e bën Shoqatën krenare dhe të shpreh mirënjohje për anëtarët e Këshillit dhe Komisioneve të Shoqatës për përkushtimin e tyre, e në veçanti Zyrën Ekzekutive për punën e palodhshme drejtë përmbushjes së misionit të organizatës tonë.



MESAZH NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE



ARDIANA BUNJAKU

Drejtoreshë ekzekutive

Të nderuar Anëtarë,

Jemi duke kaluar në një periudhë të ndryshimeve të mëdha jo vetëm në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, por edhe në aspektin e përgjithshëm ekonomik, politik dhe shoqëror.

Teknologjitë e reja po ndryshojnë mënyrën e të bërit biznes duke krijuar modele të reja të bizneseve, dhe kjo rezulton me kërkesa të reja për aftësitë e kontabilistëve dhe auditorëve dhe shërbimeve që priten nga ta.

Një trend botëror është edhe humbja e besimit të publikut tek institucionet shtetërore. Kjo vjen kryesisht si pasojë e mungesës së transparencës dhe llogaridhënies, dhe këto të dyja janë të

lidhura ngushtë me ngritjen e kapaciteteve. Një profesion i fuqishëm i kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë është i domosdoshëm për një sistem të mirëfilltë të raportimit financiar.

Kosova në vazhdimësi po zhvillon legjislacionin e saj për ta përafuar atë me “acquis communautaire” të Bashkimit Evropian. Megjithatë, sado që kjo na përfaqëson me integrimin evropian, shpeshherë ndodh që miratohen ligje tejet ambicioze të cilat Kosova nuk ka kapacitete të gatshme për t'i implementuar. Rrjedhimisht, ballafaqohemi me situata ku kemi ligje të shkruara shumë mirë në letër, por

për shkak të vështirësisë së implementimit të tyre shpesh ato keqinterpretohen apo nuk zbatohen në tërësi.

Raportimi financiar është shtyllë e domosdoshme e zhvillimit ekonomik të çdo shteti, e sidomos shteteve në tranzicion siç është Republika e Kosovës. Zhvillimi i sistemit të raportimit financiar në Kosovë në nivel të krahasueshëm me atë ndërkombëtarë do të sjellte një sërë përfitimesh drejt luftimit të korrupsionit, keq menaxhimit të parasë publike, dhe do të ndihmonte që ndërmarrjet vendore të jenë konkurrencte në tregjet ndërkombëtare, si për të tërhequr financim nga kapitali privat ashtu edhe për të shfrytëzuar mundësitë biznesore që ofrohen nga këto tregje.


Investitorët preferojnë të flasin në gjuhën të cilën ata e kuptojnë, dhe kjo mundësohet nga implementimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar si shtytje për rritjen e tregtisë ndërkufitare. Një rregullator i fuqishëm është i domosdoshëm për një profesion të mirëfilltë dhe një sistem të zhvilluar të raportimit financiar.

Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) duhet të pavarësohet financiarisht dhe ligjorisht, dhe të fuqizohet në mënyrë që të përmbushë përgjegjësitë e veta të mbikëqyrjes publike si të shoqatave profesionale, ashtu edhe të profesionistëve dhe raportimit financiar në përgjithësi.

Edhe pse ambienti për ushtrimin e profesionit në Kosovë nganjëherë mund të jetë i vështirë, Shoqata dhe anëtarët e saj kanë dëshmuar që profesionalizmi, etika, integriteti dhe vullneti ynë për zhvillim të mëtutjeshëm të profesionit do të mbeten të palëkundura. ShKÇAK do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për anëtarë si përmes shërbimeve tona për anëtarë, ashtu edhe përmes ofrimit të edukimi të vazhdueshëm profesional në mënyrë që anëtarët të jenë të gatshëm për tu përballur me zhvillimet e fundit të profesionit. Si përfundim, ju falënderoj të gjithëve për kontributin tuaj në Shoqatë dhe stafin e Zyrës Ekzekutive për punën e palodhshme dhe profesionale.



AKTIVITETET E SHKÇAK



GJATE VITIT 2019

Viti 2019 paraqet përmbylljen e një dekade gjatë të cilës ShKÇAK ka shënuar arritje të mëdha në rrugën drejt përbushjes së misionit të saj për të fuqizuar profesionin e kontabilitetit dhe auditimit [në sektorin privat dhe publik] në Kosovë dhe regjion, duke promovuar standardet më të larta të etikës, edukimit, dhe ekselencës profesionale për qëllim të mbrojtjes së interesit publik.

Gjithashtu, viti 2019 ishte viti i fundit i implementimit të plotë të Strategjisë së ShKÇAK për periudhën 2015-2019 objektivat e së cilës ishin ngritja e reputacionit të profesionistëve të sektorit privat, ngritja e kapaciteteve të profesionistëve të sektorit publik, sigurimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara nga anëtarët e Shoqatës, ofrimi i trajnimeve të specializuara në lëmit relevante të profesionit dhe fuqizimi i rolit të anëtarëve të Shoqatës.

Rrjedhimisht, një fokus i veçantë i Shoqatës gjatë këtij viti ishte zhvillimi i Strategjisë së ShKÇAK për periudhën 2020-2024 e cila do të shërbejë si udhërrëfyese e Shoqatës

për të qenë në hap me zhvillimet e fundit të teknologjisë dhe standardeve profesionale dhe për të vazhduar ofrimin e shërbimeve cilësore për anëtarët dhe studentët e saj. Strategjia e zhvilluar nga Zyra Ekzekutive në bashkëpunim me Këshillin e Shoqatës dhe e aprovuar nga Asambleja mbështetet në tri shtylla kryesore: përgatitjen e profesionistëve të së ardhmes, ofrimin e vlerës për anëtarët dhe të shërbyerit si qendër e ekselencës për zhvillim.

Në përputhje me planin e punës për vitin 2019, Shoqata ka vazhduar të implementojë programet e edukimit duke përfshirë dhe specializimet e reja në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit, të mbajë anëtarët të përditësuar me zhvillimet e fundit të profesionit përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional dhe të sigurojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga anëtarët përmes kontrollit të cilësisë.

ShKÇAK me statut është e përcaktuar që të implementojë Deklaratat e Obligimeve të

Anëtarësisë (DOA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK). Si vlerësim ndaj azhurnimit dhe dorëzimit të vazhdueshëm në kohë të Planit të Veprimit të DOA-ve, Shoqata është ndër organizatat e pakta që ka përfituar të drejtën që të azhurnojë planin e veprimit çdo dy vite në FNK, përderisa deri më tani është azhurnuar çdo vit. Departamenti i cili bën mbikëqyrjen e shoqatave anëtare të FNK ka përgatitur raportin për implementimin e kërkesave të standardeve ndërkombëtare nga SHKÇAK por edhe nga

Kosova në përgjithësi. Në këtë raport të quajtur “Dashboard Report” Shoqata ka plotësuar në nivel të lartë kërkesat e DOA-ve, si dhe stafi i FNK ka përgëzuar Shoqatën që si një shoqatë e re dhe jo shumë e madhe e një shteti në zhvillim, ka bërë punë të madhe që kërkesat e standardeve ndërkombëtare të arrihen në masë të madhe në Kosovë. Kështu azhurnimi i radhës i planit të veprimit për SHKÇAK do të bëhet në muajin Tetor 2020.

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E ASAMBLESE



Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë u mbajt me 7 qershor 2019 në Shëngjin të Shqipërisë. Në hapje të mbledhjes fjalë hyrëse mbajtën përfaqësues të Institucioneve Shtetërore të Republikës së Kosovës: Z. Shyqiri Bytyqi - Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Z. Fatmir Gashi - Zëvendës Ministër i Financave, Z. Besnik Osmani - Auditor i Përgjithshëm i Kosovës dhe Z. Afrim Maloku - Kryetar i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar.

Asambleja, si organi më i lartë qeverisës i

Shoqatës, e përbërë nga anëtarët aktiv të SHKÇAK-së votoi dhe aprovoi me shumicë votash raportin e aktiviteteve dhe raportin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2018, Strategjinë për periudhën 2020-2024, planin e punës dhe buxhetin për vitin 2020. Gjatë vitit 2019 u mbajtën zgjedhjet për anëtarët e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë për periudhën 2019-2022, ku pas votimit nga Asambleja u zgjedhën: z. Alban Lufi, znj. Elvira Ibrahim Hoti, znj. Fitore Neziri, znj. Kaltrina Kadriu Xhemaj, znj. Nekibe Haziri.



“ShKÇAK gëzon një respekt të jashtëzakonshëm dhe ky respekt nuk ka ardhur si rastësi por thjeshtë me angazhim dhe përkushtim të të gjithë udhëheqësve brenda shoqatës dhe të gjithë anëtarëve të shoqatës dhe kjo është për të përgëzuar të gjithë anëtarët e ShKÇAK.”

- Shyqyri Bytyqi, Ministër i Arsmi, Shkencës dhe Teknologjisë



“Gjatë procesit të zhvillimit të profesionit të kontabilitetit rol të rëndësishëm ka pas ShKÇAK, e cila kishte si qëllim t’i shërbejë interesave të publikut për të siguruar zhvillimin e një profesioni të fuqishëm dhe për të kontribuar në zhvillimin e një ekonomie të fortë e të qëndrueshme.”

- Fatmir Gashi, Zëvendës Ministër i Financave



“ShKÇAK është një ndër Shoqatat më të rralla, për arsye se anëtarët e saj mund t’i gjesh kudo në qeveri, institucione publike, korporata, besoj që nuk ka shoqatë të tillë ose të natyrës së tillë që ka kaq shumë mundësi për të ndikuar pozitivisht përmes anëtarëve të saj, se sa shumë ndikon e di edhe unë me punën time që e bëj në tre vitet e fundit në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA).”

- Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm i Kosovës



“Ligji i ri i cili është në fuqi bazohet në transparencë por edhe në marrjen e përgjegjësisë në përditshmëri dhe përgjegjësi më e madhe i jepet edhe Kontabilistit të Çertifikuar por edhe Auditorit të Çertifikuar dhe atij Ligjor në aspektin që ndonjëherë ka hamendje se a duhet pasqyrat financiare të nënshkruhen nga drejtori financiar apo kontabilisti i çertifikuar, dhe në këtë aspekt i është dhënë një fuqi në të cilën kontabilisti i çertifikuar domosdo i nënshkruan pasqyrat financiare.”

- Afrim Maloku, Kryetar i Këshillit Kosovar për Raportim

OBJEKTIVAT E STRATEGJISE 2020-2024

1. ZHVILLIMI I PROFESIONISTEVE TE SE ARDHMES

:: Avancimi i thirrjes profesionale

- Ngritja e vetëdijesimit mbi rëndësinë e profesionit
- Bashkëpunimi me bizneset përmes Odave Ekonomike

:: Transformimi digjital

- Përcjellja e ndryshimeve që digjitalizimi do të sjell tek sistemet e kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera
- Pajisja e anëtarëve me aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme
- Digjitalizimi i proceseve të punës të ShKÇAK

2. OFRIMI I VLERES PER ANETARET

:: Rritja, angazhimi, dhe ruajtja e anëtarëve

- Ofrimi i përfitimeve të prekshme për anëtarin

:: Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i kompetencave profesionale
- Avancimi i EVP-ve në funksion të nevojave që dalin nga kontrolli i cilësisë

:: Shërbime cilësore ndaj anëtarëve

- Ofrimi i vlerës së shtuar për anëtarët
- Shërbimet e kontrollit të cilësisë për auditorët dhe kontabilistët

3. QENDER E EKSELENCES PER ZHVILLIM

:: Ekspertiza dhe reputacioni i ShKÇAK

- Organizatë profesionale e zhvilluar në vend në tranzicion
- Shembull i mirë tek IFAC dhe organizatat tjera

:: Qendra për Hulumtim dhe Konsulencë

- Shfrytëzimi i ekspertizës së ShKÇAK për projekte ndërkombëtare
- Kryerja e hulumtimeve në çështje të ndryshme tematike

:: Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

- Shkëmbimi i përvojave me organizatat tjera rajonale dhe ndërkombëtare
- Asistimi i zhvillimit të organizatave në vende tjera në tranzicion



Në kuadër të Mbledhjes të Përgjithshme të Asamblesë, me 8 qershor 2019 u mbajt edhe sesioni i parë i Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) për vitin 2019 me temë: “Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe Kontrolli i Cilësisë”.

Gjatë EVP-së ishte prezent dhe Drejtori i Administratës Tatimore – Z. Ilir Murtezaj i cili mbajti një fjalë rasti para anëtarëve të Shoqatës dhe anëtarët patën mundësinë të diskutojnë dhe të ngritin çështje të ndryshme në lidhje me legjislacionin dhe praktikën tatimore.

Gjatë këtij sesioni të EVP-ve, ligjëruesit Z. Arbër Hoti dhe Z. Lulzim Zeka ndër të tjera u fokusuan në dhënien e sqarimeve për:

- Kërkesat e ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dhe Kontrolli i Cilësisë
- UA 07/2019 për Strukturën, Përbajtjen dhe Dorëzimin e Pasqyrave Financiare
- Raporti i Menaxhmentit
- Deklarata e Pajftueshmërisë
- Raporti i Transparencës
- Kontrolli i Cilësisë: Edicioni II-të i publikimit + Cikli i dytë i rishikimeve
- Standardi Ndërkombëtar për Angazhimet e Rishikimit 2400 (ISRE 2400)



PËRMBLEDHJE E KËRKESAVE TË LIGJIT PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM

Si klasifikohen ndërmarrjet sipas ligjit të ri për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim? Të gjitha ndërmarrjet në Kosovë klasifikohen si ndërmarrje mikro, të vogla, të mesme apo të mëdha, nëse i plotësojnë dy nga tre kriteret sipas tabelës në vijim:

	Ndermarrje mikro	Ndermarrje te vogla	Ndermarrje te mesme	Ndermarrje te medha
Totali i qarkullimit vjetor neto	0,00€ - 700.000€	700.000€ - 8.000.000€	8.000.000€ - 40.000.000€	mbi 40.000.000€
Totali i pasurise me 31.12.20XX	0,00€ - 350.000€	350.000€ - 4.000.000€	4.000.000€ - 20.000.000€	mbi 20.000.000€
Numri mesatar i te punesuarve gjate vitit	0-10	10-50	50-250	mbi 250

Kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim?

Ligji ka hyrë në fuqi më 1 janar 2019 dhe aplikohet për periudhën raportuese të vitit 2019 e tutje.

Cilat janë obligimet nëse ndërmarrja ime klasifikohet si MIKRO ndërmarrje?

Nëse një ndërmarrje plotëson dy nga tre kriteret e listuara në tabelën e mësipërme, dhe klasifikohet si MIKRO ndërmarrje, atëherë këto janë obligimet të cilat burojnë nga Ligji dhe Udhëzimet Administrative në fuqi:

Mikro ndërmarrjet ndahen në tre klasa:

Klasa I: Qarkullim (të hyra) vjetor neto më pak se 50,000€.

Klasa II: Qarkullim (të hyra) vjetor neto prej 50,000€ deri 300,000€.

Klasa III: Qarkullim (të hyra) vjetor neto mbi 300,000€.

I Raportimi financiar: Mikro ndërmarrjet e klasës I përgatisin pasqyrën e të ardhurave për periudhën raportuese sipas parimit të parasë së gatshme ose parimit aktual të kontabilitetit, në varësi të përzgjedhjes nga vetë ndërmarrja. Mikro ndërmarrjet e klasës II përgatisin pasqyrën e pozitës financiare në fund të periudhës raportuese dhe pasqyrën e të ardhurave sipas parimit aktual të kontabilitetit.

Mikro ndërmarrjet e klasës III, përgatisin pasqyrat financiare vjetore të plota në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe Mesme (SNRF për NVM-të).

II Nënshkrimi i pasqyrave financiare: Për klasën I, pasqyrat financiare nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv apo pronari. Për klasën II, pasqyrat financiare nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv/ pronari si dhe nga drejtori financiar ose kontabilisti i çertifikuar. Për klasën III, pasqyrat

financiare nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv dhe drejtori financiar, dhe nëse ky i fundit nuk është i çertifikuar si kontabilist, atëherë pasqyrat financiare nënshkruhen edhe nga Kontabilisti i Çertifikuar.

III Raportet shitesë: Pasqyrat financiare të mikro ndërmarrjeve të të gjitha klasave duhet të shpalosin:

a) numrin mesatar të të punësuarve gjatë periudhës raportuese;

b) totalin e pasurive dhe totalin e detyrimeve në datën e fundit të periudhës raportuese, si dhe

c) bazën apo parimit mbi të cilin janë ndërtuar pasqyrat financiare.

Mikro ndërmarrjet e klasës II dhe III, pasqyrave financiare duhet ti bashkëngjisin edhe deklaratën e pajtueshmërisë të nënshkruar nga drejtori ekzekutiv apo pronari dhe zyrtari kryesor financiar apo personi përgjegjës për financa, që deklarojnë se ato pasqyra financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtet në pajtueshmëri me parimet e zbatueshme të kontabilitetit.

IV Dorëzimi i pasqyrave financiare: Të gjitha mikro ndërmarrjet duhet të dorëzojnë në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) pasqyrat vjetore financiare jo më vonë se më 30 prill të vitit vijues. Mikro-ndërmarrjet të cilat përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara, afatin për dorëzim e kanë jo më vonë se më 30 qershor të vitit vijues.

Cilat janë obligimet nëse ndërmarrja ime klasifikohet si ndërmarrje e VOGËL apo e MESME (NVM)?

Nëse një ndërmarrje plotëson dy nga tre kriteret e listuara në tabelën e mësipërme, dhe klasifikohet si ndërmarrje e **VOGËL** apo e **MESME**, atëherë këto janë obligimet të cilat burojnë nga Ligji dhe Udhëzimet Administrative në fuqi:

I Raportimi financiar: të gjitha NVM-të gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare duhet të zbatojnë Standardin Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe Mesme (SNRF për NVM-të).

II Nënshkrimi i pasqyrave financiare: Pasqyrat financiare të NVM-ve nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv dhe nga zyrtari kryesor financiar. Nëse drejtori financiar apo zyrtari kryesor financiar nuk është i çertifikuar si kontabilist, atëherë pasqyrat i nënshkruan edhe kontabilisti i çertifikuar emri i të cilit figuron në regjistrin publik të kontabilistëve të çertifikuar të publikuar nga Shoqatat e Licencuara të Kontabilitetit nga KKRF.

III Auditimi i pasqyrave financiare: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara si NVM të cilat kanë qarkullim vjetor neto mbi 4,000,000€ duhet ta angazhojnë një firmë të auditimit të licencuar nga KKRF për të kryer auditimin e pasqyrave financiare vjetore.

IV Rishikimi i pasqyrave financiare: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara si NVM të cilat kanë qarkullim vjetor neto më pak se 4,000,000€ duhet ta angazhojnë një firmë të auditimit apo ndonjë auditor ligjor të licencuar nga KKRF për të kryer rishikimin e pasqyrave financiare vjetore.

V Dorëzimi i pasqyrave financiare: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara si NVM duhet të dorëzojnë pasqyrat financiare të audituara apo rishikuara në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) jo më vonë se 30 prill të vitit vijues. Nëse NVM-të bëjnë konsolidim të pasqyrave financiare, atëherë kjo datë shtyhet deri më 30 qershor të vitit vijues.

Ndëshkimet për mos dorëzim me kohë apo mos dorëzim fare variojnë nga 500€ deri në 20,000€.

Cilat janë obligimet nëse ndërmarrja ime klasifikohet si ndërmarrje e MADHE?

Nëse një ndërmarrje plotëson dy nga trekriteret e listuara në tabelën e mësipërme, dhe klasifikohet si ndërmarrje e MADHE, atëherë këto janë obligimet të cilat burojnë nga Ligji dhe Udhëzimet Administrative në fuqi:

I Raportimi financiar: të gjitha ndërmarrjet e MËDHA gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare duhet të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF/IFRS) dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK/IAS).

II Nënshkrimi i pasqyrave financiare: Pasqyrat financiare të ndërmarrjeve të MËDHA nënshkruhen nga drejtori ekzekutiv dhe nga zyrtari kryesor financiar. Nëse drejtori financiar apo zyrtari kryesor financiar nuk është i çertifikuar si kontabilist, atëherë pasqyrat i nënshkruan edhe kontabilisti i çertifikuar emri i të cilit figuron në regjistrin publik të kontabilistëve të çertifikuar të publikuar nga Shoqatat e Licencuara të Kontabilitetit nga KKRF.

III Auditimi i pasqyrave financiare: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara si të MËDHA duhet të angazhojnë një firmë të auditimit të licencuar nga KKRF për të kryer auditimin e pasqyrave financiare vjetore.

IV Raportet shtesë: të gjitha ndërmarrjet e MËDHA dhe subjektet me interes publik (SIP) përpos pasqyrave financiare, duhet të përgatisin në baza vjetore edhe: (a) raportin e menaxhmentit, i cili duhet të përmbajë një vlerësim të drejtë të zhvillimit dhe performancës së ndërmarrjes, si dhe pozitën e saj, përfshirë këtu edhe rreziqet kryesore dhe pasiguritë që kanë të bëjnë me të, (b) deklaratën e pajtueshmërisë të nënshkruar nga drejtori ekzekutiv dhe zyrtari kryesor financiar, që pasqyrat financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë, dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me Ligjin.

V Dorëzimi i pasqyrave financiare: të gjitha ndërmarrjet e klasifikuara si të MËDHA duhet të dorëzojnë për publikim pasqyrat financiare të audituara në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) jo më vonë se 30 prill të vitit vijues. Nëse ndërmarrjet e MËDHA bëjnë konsolidim të pasqyrave financiare, atëherë kjo datë shtyhet deri më 30 qershor të vitit vijues. Ndëshkimet për mos dorëzim me kohë apo mos dorëzim fare për këtë kategori të ndërmarrjeve, variojnë nga 1,000€ deri në 20,000€.

Unë jam një NVM, ku mund të gjej listën e Kontabilistëve të Çertifikuar?

Sipas legjislacionit në fuqi Kontabilist i Çertifikuar është personi i kualifikuar si kontabilist i çertifikuar nga një shoqatë e licencuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (këtu e tutje KKRF), i cili është anëtar me status të rregullt në një shoqatë profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, dhe emri i tij figuron në listën publike të kontabilistëve të çertifikuar të publikuar nga shoqatat e licencuara nga KKRF.

Kontabilisti i çertifikuar a duhet të jetë i punësuar me orar të rregullt apo mund të kontraktohet vetëm për ofrimin e shërbimeve të përgatitjes dhe nënshkrimit të pasqyrave financiare?

Legjislacioni aktual në fuqi nuk obligon ndërmarrjet që të kenë të punësuar me orar të rregullt kontabilistët e çertifikuar. Ndërmarrjet janë të lira të kontraktojnë shërbimet e përgatitjes dhe nënshkrimit të pasqyrave financiare nga kontabilistët e çertifikuar të cilët figurojnë në regjistrin publik të kontabilistëve.

KONFERENCA E PËRBASHKËT ME BAKER TILLY KOSOVO DHE ODËN EKONOMIKE TË KOSOVËS – “RISHIKIMI E PASQYRAVE FINANCIARE TË NVM”



ShKÇAK në bashkëpunim me Baker Tilly Kosovo dhe me Odën Ekonomike të Kosovës or ganizuan konferencë diskutimi në lidhje me kërkesën e re ligjore për rishikimin e pasqyrave financiare të NVM e cila derivon nga Ligji Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim në Kosovë.

Sipas kësaj kërkesë, shoqëritë tregtare të klasifikuara si ndërmarrje të vogla ose të mesme, me qarkullim neto më pak ose të barabartë me katër milion euro (4,000,000 €) së bashku me pasqyrat financiare dorëzojnë edhe raportin e rishikimit nga auditori i pavarur. Prandaj për këtë kategori të ndërmarrjeve, rishikimi i pasqyrave financiare do të zëvendësojë kërkesën për auditim. Pjesëmarrësit rreth kësaj teme u informuan gjatë prezantimit të Z. Lulzim Zeka - Auditor Ligjor.

Panelistë në këtë konferencë ishin z. Driton Pustina -Zv. Drejtor në ShKÇAK, z. Berat Rukiqi - Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, z. Ilir Murtezaj - Drejtor i Administratës Tatimore të Kosovës, z. Sokol Havolli - Zv. Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, z. Afrim Maloku - Kryetar i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, z. Alban Lufi - Këshilltar i Lartë Guvernatorit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe z. Bejtë Cakaj - Anëtar i Bordit Menaxhues në Bankën ProCredit.

Diskutimet nga panelistët dhe audienca përfshinë temat të cilat kanë të bëjnë me sfidat në zbatimin e kërkesave për raportim financiar dhe efektet e saj në transparencë financiare dhe përfitimet që mund të kenë NVM-të nga rishikimi i pasqyrave financiare.

SEMINARI ME TEMË “PROFESIONISTËT E SË ARDHMES”



Gjatë vitit 2019, ShKÇAK organizoi seminarin me temë “Profesionistët e së ardhmes” për të diskutuar rreth gjendjes aktuale të profesionit por edhe ndryshimeve që pritet të ndodhin në të ardhmen.

Seminari u hap nga Znj. Ardiana Bunjaku - Drejtoreshë Ekzekutive në ShKÇAK si dhe Znj. Afërdita Gashi- Kryetare e Këshillit të ShKÇAK dhe fjalë hyrëse mbajtën Z. Fehmi Mehmeti - Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Z. Fatmir Gashi - Zv. Ministër i Financave të Republikës së Kosovës dhe Z. Sotiraq Dhama - Kryetar i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar në Shqipëri.

Në panel diskutimi të moderuar nga Znj. Edona Perjuci-Uka - Udhëheqëse e Departamentit të Edukimit dhe Standardeve Profesionale në ShKÇAK me temën: “Roli i Standardeve

Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për integrim ekonomik dhe financiar - kërkesat dhe sfidat e implementimit”, ku panelist ishin Z. Fatmir Gashi - Zv. Ministër i Financave të Republikës së Kosovës, Z. Afrim Maloku - Kryetar i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, Z. Sotiraq Dhama - Kryetar i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar në Shqipëri, Z. Xhevdet Beqiri - Anëtarë i Këshillit në ShKÇAK, Z. Alban Lufi - Këshilltar i lartë i guvernatorit në BQK, Z. Lekë Musa - Ekspert i Fushës, Z. Berat Rukiqi - Drejtor i Odës Ekonomike të Kosovës dhe Z. Arian Zeka - Drejtor i Odës Ekonomike Amerikane.

Paneli dhe audienca diskutuan mbi temat të cilat kanë të bëjnë me sfidat e përballura në zbatimin e kërkesave për raportim financiar dhe auditim efektiv, si bazë për krijimin e një mjedisi për tërheqjen dhe ruajtjen e

investimeve të huaja dhe vendore. Po ashtu, paneli shqyrtoi tema në lidhje me ngritjen e besimit dhe llogaridhënies në menaxhim, raportimin financiar dhe auditim.

Ky seminar po ashtu ofroi mundësinë e ndarjes së eksperiencave të panelistëve si udhëheqës apo pjesëtar të institucioneve, bordeve, apo edhe komisioneve të pavarura që kanë rol kyç në zhvillimin dhe ngritjen e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, duke ndikuar kështu në mbrojtjen e interesit

publik dhe krijimin e kapaciteteve të duhura për zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Duke qenë se teknologjia do të ketë një impakt të madh mbi profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në të ardhmen, në seminar po ashtu Znj. Melita Ymeraga – Partnere në Melita & Partners prezantoi mbi “Ndërrimin e praktikave për digjitalizimin e kontabilitetit” si dhe Z. Robert Shala - Drejtor Ekzekutiv në Sentry Cybersecurity prezantoi mbi “Digjitalizimin dhe Sigurinë Kibernetike”.



SEMINARI ME TEMË: “RËNDËSIA E ETIKËS NË ZHVILLIMIN E PROFESIONIT”



Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Auditimit, ShKÇAK organizoi seminarin me temën: “Rëndësia e Etikës në Zhvillimin e Profesionit”. Seminari u hap nga Nënkryetarja e Këshillit të ShKÇAK Znj. Shpresa Mustafa e cila ju uroi mirëseardhje mysafirëve dhe theksoi se Etika është shtyllë e rëndësishme e profesionit së cilës Shoqata i kushton rëndësi të veçantë. Seminari kishte për qëllim diskutimin dhe shkëmbimin e përvojave nga organizatat e ndryshme të zbatimit të standardeve Etike dhe sfidat përkatëse. Paneli i diskutimit u moderua nga Znj. Elvira Ibrahim Hoti – Kryesuese e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë në ShKÇAK ku panelist ishin: Z. Arsim Sylja – Menaxher i Zyrës për Standarde Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës; Znj. Mirlinda Dreshaj – Zyrtare Ligjore në Njësinë e Intelgjencës Financiare; Z. Sakip Imeri – Drejtor i Përgjithshëm në

Autoritetin Kosovar të Konkurrencës; Z. Arian Zeka – Drejtor Ekzekutiv dhe përfaqësues i autorizuar i Odës Ekonomike të Kosovës; Znj. Lumnije Ajdini – Menaxhere e Përgjithshme në Aleancën Kosovare të Biznesit dhe Fitore Neziri – Anëtare e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë në ShKÇAK.

Seminari kishte për qëllim:

- Identifikimin e sfidave të implementimit të Kodit të Etikës sipas standardeve ndërkombëtare;
- Promovimin e mënyrave për raportimin e sjelljeve jo-etike dhe menaxhimin e rasteve të tilla;
- Diskutimin mbi ndikimin e Etikës në rritjen e besueshmërisë në raport me palët tjera;
- Promovimin dhe krijimin e ambientit pozitiv brenda institucioneve bazuar në parimet më të larta të Etikës.

CEREMONIA E ÇERTIFIKIMIT TË EKSPERTËVE TË LICENUCAR TË FORENZIKËS FINANCIARE PËR ZYRTARËT E INSTITUCIONEVE PUBLIKE



Gjatë vitit 2019 u mbajt ceremonia e ndarjes së Çertifikatave për Ekspertët e Licencuar të Forenzikës Financiare nga ShKÇAK dhe UNDP për zyrtarët e institucioneve publike të cilët përfunduan me sukses ligjëratat dhe provimet e programit specializues të ShKÇAK-së, Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare, mbështetur nga UNDP dhe financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim dhe programi DANIDA i Qeverisë së Danimarkës.

Programi për Ekspert të Licencuar të Forenzikës Financiare ishte zhvilluar nga ShKÇAK dhe UNDP me qëllim të përgatitjes së ekspertëve të licencuar të forenzikës financiare duke i pajisur ata me njohuri, aftësi dhe ekspertizë të duhur që rezultojnë të jenë thelbësore për luftimin e korrupsionit

si parakusht për zhvillimin e ekonomisë në Kosovë. Ekspertët e Licencuar të Forenzikës Financiare do t'i përshpejtojnë në masë të madhe hetimet dhe do të sigurojnë një numër më të madh të aktakuzave të rasteve të korrupsionit dhe krimeve financiare.

Me këtë rast para kandidatëve të çertifikuar mbajtën fjalë mirëseardhje Z. Patrick Etienne - Drejtor në Zyrën Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Z. Anders Kragh Bingen - Përfaqësues i DANIDA, Znj. Valbona Bogujevci - Asistente e Përfaqësueses së Përhershme dhe Koordinatore e Programit në UNDP dhe Znj. Ardiana Bunjaku - Drejtoreshë Ekzekutive e ShKÇAK, të cilët folën për rëndësinë e këtij programi në luftën kundër korrupsionit, si mënyra e vetme për rritjen e stabilitetit,

ngritjen e besimit të publikut në institucionet publike dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Fjalë rasti mbajtën edhe Z. Aleksandër Lumezi - Kryeprokuror, Z. Rashit Qalaj - Drejtor i Policisë, Z. Shaip Havolli - Drejtor i Agjencisë Anti-Korrupsion, Z. Dardan Nuhiu - Drejtor i Njësitit të Inteligjencës Financiare, Z. Ilir Murtezaj - Drejtor i Administratës Tatimore dhe Z. Bahri Berisha - Drejtor i Shërbimit Doganor.

Udhëheqësit e institucioneve publike falënderuan donatorët për financimin e këtij projekti, UNDP dhe SHKÇAK për

implementimin e programit specializues, dhe përgëzuan të çertifikuarit në këtë program duke theksuar se ata do të jenë pasuri brenda institucioneve publike me aftësi dhe ekspertizë për të luftuar korrupsionin, krimet ekonomike dhe ekonominë jo formale.

Grupi i parë i kandidatëve të çertifikuar në këtë program ka qenë i përbërë nga zyrtarë të Policisë së Kosovës, Prokurorisë Speciale të Kosovës, Njësisë për Inteligjencë Financiare, Administratës Tatimore të Kosovës, Agjencisë Kundër Korrupsionit, Doganës së Kosovës, dhe BIRN, të cilët janë të përfshirë në aktivitetet anti-korrupsion.



ANËTARËT E SHKÇAK DËSHMOJNË PËRKUSHTIMIN PËR PROFESIONALIZËM DHE MBROJTJE TË INTERESIT PUBLIK



Që nga themelimi i Shoqatës, anëtarët e saj përmes Statutit janë përcaktuar për përmbushjen e Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK. DOA-të e FNK përcaktojnë obligimet që duhet të përmbushen nga organizatat anëtare të FNK për të mbështetur adoptimin dhe implementimin e standardeve ndërkombëtare të lëshuara nga bordet ndërkombëtare standardvënëse, dhe krijimin e sistemeve të sigurimit të cilësisë dhe sistemeve investiguese dhe disiplinore. Për të qenë në pajtueshmëri me DOA 1 mbi “Sigurimin e Cilësisë” dhe duke u bazuar në kërkesat e Ligjit për “Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim” si dhe rekomandimet e raportit ROSC të Bankës Botërore, Shoqata për shumë vite ka investuar dhe punuar drejt

themelimit dhe zhvillimit të funksionit të kontrollit të cilësisë brenda saj, gjë që është arritur përmes binjakëzimit me organizatat Royal NIVRA dhe PUM nga Holanda.

Ligji i ri për “Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim” i cili hyri në fuqi me 1 janar 2019 parasheh themelimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda Këshillit Kosovar për Raportim Financiar i cili ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen e arsimimit të vazhdueshëm, sistemeve të sigurimit të cilësisë, dhe sistemeve hetuese dhe disiplinore. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, gjatë vitit 2019 KKRF lëshoi njoftim tek shoqatat dhe Auditorët Ligjorë ku thuhet se mbikëqyrja publike është kompetence e Bordit të Mbikëqyrjes Publike të KKRF dhe se Shoqatat profesionale nuk

kanë të drejtë të kryejnë kontroll të cilësisë të Auditorëve Ligjorë dhe Firmave të Auditimit, e as të ngarkojnë anëtarët me tarifa shtesë për kontroll të cilësisë.

Për shkak të konfuzionit të krijuar nga njoftimi i lëshuar nga KKRF mbi të drejtën e shoqatave për të kryer kontroll të cilësisë, ShKÇAK kërkoi opinion ligjor nga Ministria e Financave nga e cila u pranua përgjigjja se "Zhvillimi i kontrollit të cilësisë për qëllimet e ligjit është përgjegjësi vetëm e KKRF-së. KKRF është i vetmi organ i cili e zhvillon kontrollin e cilësisë për qëllimet e Ligji dhe mund të shqiptojë sanksione për të gjeturat gjatë zhvillimit të kontrollit të cilësisë. Në anën tjetër, Ligji nuk ka ndaluar që shoqatat të zhvillojnë aktivitetet lidhur me kontrollin e cilësisë me anëtarësinë e tyre. Por, ky aktivitet nuk e ka kuptimin e kontrollit të cilësisë sipas dispozitave të Ligjit dhe çdo aktivitet i tillë i zhvilluar nga shoqatat nuk do

të zëvendësojë apo nuk do të ketë efekt mbi kontrollin e cilësisë sipas Ligjit".

Shoqata gjithashtu zhvilloi takime me anëtarët e saj, ku pas shumë diskutimeve anëtarët Auditorë Ligjorë u përcaktuan që të vazhdohet me funksionin e kontrollit të cilësisë nga shoqata duke marrë parasysh që ky kontroll nuk kryhet për qëllime të mbikëqyrjes publike, por për qëllim të edukimit dhe përmirësimit të cilësisë së punës të anëtarëve.

Për të evituar konfuzionin mbi dallimin e kontrollit të cilësisë të kryer nga Shoqata nga ai që do të kryhet nga KKRF për qëllim të mbikëqyrjes publike, Komisioni i ShKCAK për Menaxhimin e Cilësisë mori vendim që funksioni i kryer nga shoqata të riemërohet si Menaxhimi i Cilësisë për Pajtueshmëri me Standarde.



SHKÇAK MBËSHTET FNK-NË NË VLERËSIMIN E OPK-VE TJERA NGA KOSOVA



Pas pranimit të kërkesës janë zhvilluar takime me përfaqësues të FNK dhe me përfaqësues të IKAF, në bazë të të cilave Këshilli i ShKÇAK ka marrë vendim që Shoqata së pari të kryejë një due diligence të IKAF për të vlerësuar veprimtarinë dhe statusin e përmbushjes së DOA-ve nga kjo organizatë, para se të vazhdohet me proceset e tjera. Për kryerjen e due diligence, ShKÇAK ka siguruar mbështetjen e Royal NBA - organizatë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit nga Holanda dhe njëkohësisht sponsori i ShKÇAK për anëtarësim në FNK, dhe procesi pritet të fillojë pas pranimit të dokumentacionit të kërkuar nga IKAF.

Cjatë vitit 2019, ShKÇAK ka pranuar kërkesën për sponsorim për të filluar procesin e aplikimit për anëtarësim në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve nga Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa (IKAF), shoqatë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit e licencuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF).

Kërkesa nga IKAF është e bazuar në procedurat e FNK sipas të cilave shoqatat që synojnë anëtarësim dhe vijnë nga vendet në të cilat tashmë ekziston një shoqatë anëtarë me të drejta të plota në FNK, duhet që së pari të kontaktojnë shoqatën e cila është anëtare dhe të sigurojnë mbështetjen e saj për të vazhduar me procesin e aplikimit për anëtarësim.

PROGRAME ÇERTIFIKUESE TË BARASVLEFSHME ME NIVELET MË TË LARTA BOTËRORE



Viti 2019 ka shënuar rritje të numrit të kandidatëve të interesuar për të ndjekur edukimin profesional në kontabilitet dhe auditim, dhe Shoqata ka vazhduar te përkujdeset që atyre të i'u ofrohen programe çertifikuese dhe specializuese të bazuara në standardet ndërkombëtare të edukimit. Shoqata edhe këtë vit ka vazhduar me aktivitetet e programeve certifikuese të sektorit privat, publik dhe auditimit të brendshëm si dhe me ofrimin e programeve specializuese në fushën e forenzikës financiare dhe tatimeve.

Duke u bazuar në marrëveshjen me BPP LearningMedia, ofruesin botëror të materialeve të studimit për kontabilitet dhe auditim, Shoqata gjatë vitit ka punuar intenzivisht në azhurnimin e materialeve në gjuhën shqipe në mënyrë që kandidatët të fitojnë njohuritë më aktuale duke përfshirë këtu standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) dhe standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të rishikuara.



Gjatë vitit 2019 programi çertifikues i ShKÇAK është ri akredituar nga Shoqata e Auditorëve të Çertifikuar në Angli (ACCA) për vitet 2019-2023. ACCA është njëra ndër organizatat më të njohura profesionale globale e shpërndarë në 52 shtete me 208,000 anëtarë dhe 503,000 studentë, anëtare me të drejta të plota e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) dhe e cila bashkëpunon me më shumë se 323 partnerë global të organizatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit. Ri akreditimi ka përfshirë një proces të detajuar të monitorimit nga ana e ACCA-së mbi nivelin e matjes së njohurive i cili ka rezultuar me vazhdim të njohjes së thirrjes “Auditor i Certifikuar” të ShKÇAK nga ana e ACCA. Kjo është një arritje e veçantë për Shoqatën dhe anëtarët e saj, pasi që u mundëson atyre të jenë konkurrent në tregun global të punës.

Shoqata gjithashtu ka përgatitur dhe dorëzuar formularët e aplikimit dhe programet modulare në Agjensionin Kombëtar të Kualifikimeve për të gjitha programet çertifikuese, atë të sektorit privat, sektorit publik dhe auditimit e brendshëm. Shoqata ka pranuar përgjigje pozitive nga Këshilli Drejtues i këtij institucioni për aprovimin e dokumentacionit të dorëzuar për vazhdimin e akreditimit të programeve certifikuese.

ShKÇAK ka zhvilluar edhe procesin e rekrutimit të ligjëruesve potencial për të ardhmen të cilët në pajtueshmëri me SNE kanë kaluar nëpër procesin e “Trajnimit të trajnerëve” në mënyrë që të sigurohet një fond i mjaftueshëm i ligjëruesve për angazhim të në të ardhmen.



MIRËMBAJTJA DHE PËRDITËSIMI I NJOHURIVE PËRMES EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL



Krahas kërkesave ligjore për përditësim të njohurive të profesionistëve, është e domosdoshme që profesionistët të jenë të përgatitur për ndryshimet e vazhdueshme në tregun e punës siç janë azhurnimi i standardeve dhe teknologjitë e reja në mënyrë që të ofrojnë shërbime cilësore për klientët apo për punëdhënësit e tyre.

Shoqata ka vazhduar të ofrojë sesione të EVP me tema relevante për profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, të cilat janë bazuar në kërkesat e vetë profesionistëve, në zhvillimet dhe ndryshimet ligjore që kanë ndodhur në vend dhe në botë si dhe në

çështje të rëndësishme që ka identifikuar Departamenti i Kontrollit të Cilësisë i Shoqatës gjatë punës së tyre.

Gjatë vitit 2019, ShKÇAK ka nënshkruar marrëveshje me Zyrën Kombëtare të Auditimit përmes së cilës profesionistët e punësuar në këtë institucion do të mund të ndjekin sesionet e EVP-ve të Shoqatës. Përmes përditësimit të njohurive të profesionistëve të këtij institucioni, ShKÇAK kontribuon në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit të parësë në të gjitha institucionet shtetërore.

EVP-të e realizuara gjatë vitit 2019:

- :: Ligji 06/L-032 Ligji për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim dhe Kontrolli i cilësisë
- :: SNRF 16 - Lizingu
- :: SNRF 17 - Kontratat e sigurimeve
- :: Zbatimi në praktikë i procedurave të Auditimit
- :: Parandalimi i pastrimit të parave me shembuj praktik
- :: SNRF 15- Të hyrat nga kontratat me klientët
- :: Rëndësia e Etikës në zhvillimin e profesionit
- :: Kodi i Etikës
- :: Standardi ndërkombëtar për angazhimet e rishikimeve (2400)
- :: Azhurnimet e fundit në legjislacionin tatimor
- :: Vlerësimi i investimeve kapitale (buxhetimi i kapitalit)



PËRPRJEKJE TË VAZHDUESHME PËR OFRIMIN E VLERËS SË SHTUAR PËR ANËTARËT



Edukimi profesional



domosdoshmëri për zhvillim



Gjatë vitit 2019, ShKÇAK në vazhdimësi ka informuar anëtarët e saj për ndryshimet e fundit në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në mënyrë që ata të jenë të pajisur me informata të përditësuara dhe të jenë të gatshëm për të ofruar shërbime profesionale të nivelit të lartë. Përveç informimit mbi ndryshimet e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar apo standardeve ndërkombëtare të auditimit, anëtarët e ShKÇAK kishin mundësinë të jenë pjesë e standard vënies përmes komentimit në draftet e publikuara nga bordet ndërkombëtare standard-vënësë. Promovimi i anëtarëve të ShKÇAK dhe

thirrjeve profesionale që ata mbajnë ka vazhduar të jetë në fokus të Shoqatës. Në kuadër të kampanjës promovuese të ShKÇAK dhe anëtarëve të saj “Ndërto të ardhmen tënde me SCAAK”, janë publikuar videot e storieve të suksesit nga anëtarët e ShKÇAK të cilat kanë rezultuar shumë të suksesshme si në aspektin e ngritjes së vetëdijesimit të publikut mbi rëndësinë e profesionistëve të mirëfilltë, ashtu edhe në tërheqjen e gjeneratave të reja për të ndjekur një karrierë në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit. Gjithashtu, është lansuar edhe kampanja e ShKÇAK “Edukimi profesional, domosdoshmëri për zhvillim”, ku përmes mesazheve nga përfaqësues të institucioneve të larta shtetërore dhe palëve

të tjera të interesit është theksuar rëndësia e edukimit profesional dhe impakti pozitiv që ky edukim ka në zhvillimin e institucioneve apo organizatave të ndryshme. Protagonistët e kësaj kampanje theksuan rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm profesional si mënyrë e mirëmbajtjes dhe përditësimit të njohurive në çfarëdo fushe për të ushtruar profesionin në mënyrë të mirëfilltë.

Gjatë vitit 2019 ka vazhduar trendi i rritjes së kërkesës nga bizneset për profesionistë që mbajnë thirrje profesionale nga ShKÇAK. Anëtarët dhe studentët janë informuar rregullisht për konkurse pune nga biznese dhe institucione që kanë kërkuar kontabilistë dhe auditorë të çertifikuar nga ShKÇAK si një ndër kërkesat kyçe për pozitat e hapura.

Shoqata në vazhdimësi ka bërë përpjekje për të qëndruar sa më afër gjeneratave të reja për t'u siguruar që ata të jenë të mirë informuar mbi një karrierë prospektive në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. ShKÇAK ka marrë pjesë në panairin e karrierës të organizuar nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe ka mbajtur sesione informuese me studentët e Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Prishtinës. Sesioni pati për qëllim informimin e studentëve mbi mundësitë e zhvillimit të karrierës në kontabilitet dhe auditim dhe mbi programet çertifikuese të ShKÇAK-së. Studentët kanë pasur mundësinë të parashtronë pyetje dhe këtë sesion e kanë vlerësuar si të dobishëm për të vendosur për të ardhmen e tyre profesionale.



PAJTUESHMËRIA ME STANDARDE PROFESIONALE PËRMES MENAXHIMIT TË CILËSISË



Sipas planit paraprak të aprovuar nga Komisioni i Menaxhimit të Cilësisë së ShKÇAK, Departamenti i Menaxhimit të Cilësisë për Pajtueshmërinë me Standarde (DMCPS) ka vazhduar me rishikimin e angazhimeve të auditimit të auditorëve ligjorë, anëtarë të ShKÇAK.

Po ashtu, DMCPS ka vazhduar me analizën e 200 pasqyrave financiare të audituara të ndërmarrjeve të mëdha në Kosovë për periudhën kontabël 2017 dhe 2018, të cilat janë dorëzuar në KKRF deri në prill të vitit 2018 dhe 2019. Pritet që gjatë fillimit të vitit 2020 të finalizohet raporti i hulumtimit dhe rezultatet të bëhen publike. Qëllimi i këtij hulumtimi

është të shikohet pajtueshmëria e pasqyrave financiare me SNRF/SNK, SNRF për NVM dhe SNA.

Gjatë muajit shtator 2019 është mbajtur takim me Komisionin për Menaxhim të Cilësisë ku janë aprovuar raportet e vlerësimit të auditorëve të përzgjedhur për kontroll të cilësisë të ciklit të dytë dhe një raport vlerësimi nga ri-kontrolli për sigurim të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga kontrolli paraprakë. Gjithashtu në mbledhje të Komisionit është prezantuar plani i deri tanishëm i punës së departamentit dhe janë shqyrtuar mundësit për veprim të

mëtutjeshëm lidhur me mos përgjigjen e auditorëve ndaj kërkesave të shoqatës, me rastin e lëshimit të një njoftimi nga KKRF për kontrollin e cilësisë.

Në mbledhje të Komisionit janë prezantuar dy draft propozime për ndryshime në punën e departamentit të kontrollit të cilësisë, me ç' rast është aprovuar draft propozimi në të cilin kontrolli i cilësisë propozohet të mbetet e obligueshme duke pasur parasysh nivelin e përgjithshëm të punës të anëtarëve të shoqatës. Gjithashtu është propozuar që të fillojnë të raportojnë në shoqatë edhe kontabilistët e çertifikuar dhe t'iu ofrohet edhe atyre mundësia për kontroll për sigurim të pajtueshmërisë me standarde. Synimi ynë është ofrimi i mundësisë në ngritjen e nivelit të cilësisë së punës të anëtarëve të shoqatës, si dhe ti përgatis ata për kontrollën publike e cila pritet të kryhet nga KKRF-ja. Komisioni për sigurim të cilësisë gjithashtu ka marrë vendim që termi kontroll e cilësisë të zëvendësohet me termin menaxhimi i cilësisë për pajtueshmërinë me standardet e profesionit.

Gjatë 2019, DMCPs ka përgatitur hulumtimi lidhur me 'Etikën dhe tarifat e ulëta të auditimit' duke u bazuar në të dhënat vjetore të grumbulluara nga auditorët ligjor. Gjetjet nga ky hulumtim janë prezantuar në takimin e mbajtur me auditor gjatë javës së Etikës, në muajin tetor. Raporti i finalizuar i këtij hulumtimi pritet të bëhet publik gjatë fillimit të vitit 2020.

Në muajin Nëntor, DMCPs ka mbajtur takim me Komisionin për Menaxhim të Cilësisë në të cilin janë aprovuar letrat e punës të azhurnuara, hulumtimi i Etikës dhe Tarifave të ulëta të auditimit, si dhe është aprovuar lista me auditorët e përzgjedhur për zhvillimin e aktivitetit të menaxhimit të cilësisë, cikli i tretë, si dhe janë caktuar datat për mbajtjen e takimeve.

DMCPs gjithashtu ka përgatitur materialin për dërgim të auditorët për informim lidhur me publikimin e SNA/ISA 315 (i rishikuar 2019). Të dhënat lidhur me fillimin e aplikimit të SNA 315 (i rishikuar) dhe diskutimet e pritshme për implementimin e tij i'u janë dërguar departamentit të shërbimit për anëtarë dhe departamentit të marketingut për shpërndarje tek auditorët ligjor dhe auditorët e çertifikuar. Gjithashtu është informuar departamenti i shërbimit për anëtarë për informim të anëtarëve lidhur me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjorë dhe firmave të auditimit, si dhe, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2019 për strukturën, përmbajtjen dhe dorëzimin e raportimeve vjetore financiare.

SHKÇAK LUAN ROL AKTIV NË ZHVILLIMET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Edhe gjatë vitit 2019, ShKÇAK ka vazhduar të jetë aktive në zhvillimet e fundit në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit si në vend ashtu edhe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Shoqata ka organizuar konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta për të informuar anëtarët e saj dhe palët tjera me interes mbi ndryshimet e fundit të profesionit, por edhe për të identifikuar sfidat e tyre në implementimin e kërkesave të reja ligjore.



TRYEZA E RRUMBULLAKËT PËR PROJEKTLIGJIN PËR “ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT”

ShKÇAK në bashkëpunim me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë organizoi tryezë diskutimi me biznese dhe profesionistët e kontabilitetit për të diskutuar komentet dhe rekomandimet mbi projektligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i cili parasheh ndryshime dhe plotësime substanciale në krahasim me ligjin paraprak.

Pjesëmarrësit u njoftuan mbi ndryshimet të cilat parashihen në këtë projektligj në lidhje me deklaratat tatimore, vetë-vlerësimin, pagesat, interesin, kreditimet, dhe rimbursimet.

Cjithashtu u prezantuan rekomandimet e bëra nga Komisioni i Tatimeve i ShKÇAK të cilat përfshijnë lehtësimin e veprimtarisë së bizneseve si dhe qartësimin e neneve të caktuara në legjislacionin tatimor. Pjesë e panelit për diskutim ishin z. Arbër Hoti – Udhëheqës i Departamentit të Kontrollit të Cilësisë në ShKÇAK, z. Fahri Breznica – Kryesues i Komisionit për Tatime dhe znj. Gresa Rexhepi - Kryesuese e Komitetit Tatimor të Odës Amerikane. Komentet e pranuar nga pjesëmarrësit, pas rishikimit nga

Komisioni i Tatimeve të Shoqatës u përcjellën në Ministrinë e Financave për tu shqyrtuar para përgatitjes së draftit final të projektligjit. Si anëtare e OEAK, Shoqata gjithashtu është përfaqësuar në tryeza të organizuara nga Oda për të diskutuar dhe dhënë kontributin në çështje të rëndësishme për sektorin privat siç janë politikat fiskale, ligji i punës dhe mungesa e fuqisë punëtore që posedon aftësi të kërkuara nga bizneset, luftimi i korrupsionit dhe ekonomisë joformale, pronësia intelektuale dhe të tjera.



Forumin i Politikave Fiskale i organizuar nga OEAK kishte për qëllim diskutimin e çështjeve tatimore dhe doganore me të cilat përballesh bizneset në Kosovë dhe zgjidhjet e mundshme që mund të kenë këto çështje në mënyrë që të lehtësohet mënyra e të bërit biznes. Në panel të këtij forumi ishin z. Ilir Murtezaj – Drejtor i Administratës Tatimore të Kosovës dhe z. Bahri Berisha – Drejtor i Doganës së Kosovës. Përfaqësuesit e ShKÇAK gjatë forumit paraqitën problemet kryesore

të cilat hasen nga kontabilistët gjatë punës së tyre me biznese.

Në prag të ndryshimeve në legjislacionin fiskal që ndodhën gjatë vitit 2019, përfaqësues të Shoqatës morën pjesë në diskutimin publik të organizuar me ish Ministrin e Financave z. Bedri Hamza dhe me anëtarët e OEAK mbi efektet e reformave fiskale në mjedisin e veprimtarisë së biznesit në Kosovë, ku u diskutuan sfidat me të cilat përballesh bizneset

në kuadër të pakos aktuale fiskale në Kosovë dhe përmirësimet që priten nga pakoja e re fiskale.

ShKÇAK gjithashtu u përfaqësua nga znj. Ardiana Bunjaku - Drejtor Ekzekutiv dhe z. Fahri Breznica - Kryesues i Komisionit për tatime në tryezën e organizuar nga ATK dhe USAID për konsultime publike me palët e interesit për hartimin dhe zbatimin e Planit për përmirësimin e integritetit. Ky plan ka për qëllim të identifikojë fushat për përmirësim që kontribuojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në ambiciet e menaxhmentit për përmirësimin e efikasitetit dhe të integritetit të ATK-së. Hartimi i këtij plani është duke u mbështetur nga Programi i USAID-it për Qeverisjen Ekonomike në Kosovë.

Tryeza e rrumbullakët mbi “Efektet Pozitive të Falimentimit dhe Ristrukturimit për Bizneset” u organizua nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore, në bashkëpunim me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë organizoi tryezë të rrumbullakët ku përfaqësuesit e ShKÇAK morën pjesë krahas bizneseve, bankave, dhe palëve të tjera të interesit për të diskutuar rreth efekteve pozitive të falimentimit dhe riorganizimit. Gjatë takimit, Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK znj. Ardiana Bunjaku potencoi se ShKÇAK ka disa vite që ka zhvilluar programin e insolvencës dhe se

tashmë një numër i anëtarëve të saj janë të çertifikuar si specialist të insolvencës, dhe se duhet të ketë koordinim të donatorëve në mënyrë që të mos ketë dublikim të projekteve në këtë fushë.

Tryeza me temën “Rezultatet dhe gjetjet nga studimi bazë mbi drejtësinë komerciale” kishte për qëllim prezantimin e gjetjeve nga studimi përmes të cilit është synuar që të evidentohet gjendja aktuale lidhur me njohuritë, përvojën, qëndrimin e qytetarëve dhe bizneseve ndaj sistemit të Drejtësisë Komerciale në Kosovë, proceset dhe institucionet që ndihmojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve komerciale. Nga studimi ka dalë si përfundim se nevojitet ende të punohet në vetëdijësimin e bizneseve për mënyrat alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Në kuadër të fushës së drejtësisë, edhe tryeza “Sundimi i Ligjit: Çka tutje?” kishte për qëllim identifikimin e prioritetëve për qeverinë që do të kontribuonin në implementimin adekuat të legjislacionit. Nëradshtetë parëu theksua nevoja e themelimit të gjykatës komerciale që do të konsiderohej si reformë tejet e rëndësishme në drejtësi. Implementimi adekuat i kornizës ligjore dhe intervenimi profesional dhe në kohë i institucioneve në rastet kur evidentohen shkeljet e konkurrencës së lirë esenciale për zhvillimin e ambientit të favorshëm biznesor dhe për tërheqjen e investitorëve të jashtëm.



AVANCIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE NË KOSOVË

Gjatë vitit 2019, ShKÇAK është ftuar nga Departamenti i OJQ-ve i Ministrisë së Administratës Publike, për të qenë pjesë e grupit punues për draftimin e Udhëzimit Administrativ për Implementimin e Ligjit të ri për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare. Konkretisht është kërkuar nga ShKÇAK si shoqatë e ekspertëve të kontabilitetit dhe auditimit, të krijoj një propozim që do të rregullojë raportimin financiar të OJQ-ve dhe do të harmonizojë raportet e auditorëve ligjorë me raportet që dorëzohen nga OJQ-të në DOJQ. ShKÇAK është përfaqësuar në këtë grup punues nga z. Xhevdet Beqiri – anëtar i Këshillit të Shoqatës. Ndonëse nuk ka ndonjë standard

ndërkombëtarë të raportimit financiar të OJQ-ve, kjo çështje është rregulluar në mënyra të ndryshme në shtete të ndryshme të botës. Në rastin e Kosovës, duke u bazuar në mënyrën se si funksionojnë OJQ-të dhe në nevojat e DOJQ-së, nga ShKÇAK është propozuar që të përdoren Standardi Ndërkombëtarë i Raportimit Financiar (SNRF) për NVM dhe janë përgatitur format e raportimit të përshtatura për funksionet dhe terminologjinë e OJQ-ve. Propozimi i ShKÇAK është inkorporuar në Draft UA dhe Departamenti i OJQ ka filluar punën në përditësimin e formave të raportimit online sipas formave të propozuara nga ShKÇAK.



KONFERENCA E 11 E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT ME TEMË: RRIJTJA E NDIKIMIT TË AUDITIMIT NË PËRMIRËSIMIN E QEVERISJES NË SEKTORIN PUBLIK



Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në konferencën e 11-të Vjetore të organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit me temë qendrore "Rritja e ndikimit të auditimit në përmirësimin e qeverisjes në sektorin publik" e cila u mbajt në Strugë dhe u organizua në bashkëpunim profesional dhe me përkrahjen financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë. Përveç ShKÇAK, pjesëmarrës në këtë konferencë ishin dhe përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit nga Suedia, Polonia, Turqia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, dhe Mali i Zi. Po ashtu, pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues të OSBE-

së, Institucioneve Publike, ish-anëtare të komisioneve parlamentare, shoqërisë civile dhe mediave.

Përfaqësues të ShKÇAK gjithashtu morën pjesë në tryezën e organizuar nga ZKA me temë "Maksimizimi i ndikimit të auditimit të performancës përmes komunikimit efektiv me palët e interesit" e cila kishte për qëllim që bashkërisht me organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat profesionale të bëhet identifikimi i sfidave me të cilat ballafaqohen institucionet publike që ndikojnë në performancën e tyre dhe rrjedhimisht afektojnë shërbimet për qytetarët dhe mirëqenien në përgjithësi.

PUNËTORIA E PROJEKTIT KUNDËR KRIMIT EKONOMIK NË KOSOVË (PECK II)



Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në punëtorinë e Projektit PECK II në lidhje me Udhëzuesin dhe Mjetet lidhur me qasjen dhe mbikëqyrjen e bazuar në rrezik të inspektimeve për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (PPP/LFT).

Gjatë punëtorisë u prezantua kuptimi i rrezikut nga mbikëqyrësit, vlerësimi i rrezikut sektorial dhe profilizimi entiteteve individuale, zhvillimi i vlerësimeve të rrezikut dhe profilizimit të rrezikut, kryerja e inspektimeve dhe përgatitja e planeve të inspektimit. Në fund të sesioneve nga pjesëmarrësit është kërkuar që në grupe të punojnë dhe prezantojnë lidhur me temat e punëtorisë.

TRAJNIMI I BANKËS BOTËRORE ME TEMË “GATISHMËRIA E BALLKANIT PERËNDIMOR PËR

Duke qenë se gjithnjë e më shumë bëhet evidente që roli i kontabilistëve nuk është vetëm të ndihmojnë bizneset rreth raportimit financiar por edhe të këshillojnë ato drejt rritjes, është e rëndësishme që kontabilistët të kenë njohuri mbi mundësitë e bizneseve për sigurimin e kapitalit privat.

Përfaqësues të Zyrës Ekzekutive si dhe anëtarët e ShKÇAK morën pjesë në trajnimin një ditore të organizuar nga Banka Botërore me temë “Gatishmëria e Ballkanit Perëndimor për Investime të Kapitalit Privat - Mbështetje e menaxhimit financiar për NMVM për qasje në financim nga kapitali privat”. Ky trajnim përfshiu diskutime në panel dhe diskutime informuese se si ofruesit e shërbimeve të menaxhimit financiar dhe stafi i NMVM-ve mund të mbështesin NMVM-të të jenë të gatshme për t’u qasur në investimet e kapitalit privat.

KONFERENCA MBI DIALOGUN PUBLIKO-PRIVAT NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT TË SEKTORIT PRIVAT



Përfaqësuesit e ShKÇAK morën pjesë në Konferencën mbi Dialogun Publiko-Privat në Funkcion të Zhvillimit të Sektorit Privat. Konferenca u organizua nga Zyra e Komunitetit të Biznesit të Kuvendit të Kosovës ku Shoqata është anëtare, me qëllim të shtjellimit të temave si konkurueshmëria e prodhimeve vendore, sundimi i ligjit, projektligji për identifikim elektronik dhe tregu i punës në Kosovë.

Përfaqësuesit e bizneseve patën mundësinë që të diskutojnë me përfaqësues të lartë të Qeverisë rreth problemeve dhe sfidave me të cilat ata ballafaqohen dhe pengesave që duhet të mënjahen për të përmirësuar ambientin e të bërit biznes në Kosovë.

SHKÇAK NË BASHKËPUNIM TË VAZHUESHËM ME ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS



Përfaqësues të ShKÇAK u ftuan në takim nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së z. Ilir Murtezaj për të diskutuar rreth bashkëpunimit me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve profesionale në fushën e kontabilitetit, edukimin e vazhdueshëm profesional, organizimin e seminareve dhe kampanjave edukative për raportimin e drejtë financiar si aktivitete të rëndësishme për përmbushjen tatimore. Cjatë takimit palët u dakorduan që bashkëpunimi të vazhdojë dhe të zgjerohet edhe më shumë në periudhat e ardhshme.

SHKÇAK SHËNON JAVËN BOTËRORE TË ETIKËS



Për të shënuar Javën Botërore të Etikës, duke marrë parasysh edhe ndryshimet e fundit në legjislacionin vendor e posaçërisht ato ndryshime të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në profesionin por edhe në punën e Auditorëve Ligjorë si profesionistë të fushës, Këshilli i ShKÇAK ftoi në një takim Auditorët Ligjorë me të cilët bashkërisht diskutuan në lidhje me ndryshimet ligjore dhe rregullativën aktuale e me theks të veçantë në kërkesat ligjore ndaj Shoqatës dhe ndaj anëtarëve të saj.

Gjatë këtij takimi u prezantuan edhe te gjeturat nga hulumtimi i Departamentit të Kontrollit të Cilësisë i cili kishte për qëllim të analizoj kërkesat që dalin nga Kodi i Etikës për profesionistët e fushës së kontabilitetit dhe auditimit, si dhe rreziqet që krijohen në rastin e ofertimit të tarifave të ulëta të auditimit.

FUQIZIMI I PROFESIONIT PËRMES ZGJERIMIT TË BASHKËPUNIMIT RAJONAL



Gjatë vitit 2019 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit mes ShKÇAK dhe Institutit të Kontabilistëve të Miratuar (IKM) nga Shqipëria, organizatë profesionale e kontabilitetit e cila gjatë këtij viti është pranuar si anëtare me të drejta të plota në FNK.

Marrëveshje e nënshkruar ka si objektiv vendosjen e bashkëpunimit midis të dy organizatave profesionale me qëllim që të bashkërendohen përpjekjet:

- :: në fushën e përkthimit dhe përshtatjen e literaturës në fushën e kontabilitetit, etikës, SNRF-ve dhe të shërbimeve të tjera të lidhura, të shpallura nga IFAC dhe Standard vënësit tjerë global;
- :: për kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e edukimit, të promovimit të cilësisë dhe të etikës profesionale midis anëtarëve të dy organizatave profesionale;
- :: për shkëmbimin e përvojave përmes organizimit të aktiviteteve shkencore dhe profesionale (seminare, ëork-shop, konferenca, etj); dhe
- :: në fusha të tjera me interes reciprok.

SHKÇAK INTEGROHET TUTJE NË STRUKTURAT E FEDERATËS NDËRKOMBËTARE TË KONTABILISTËVE DHE AUDITORËVE



ShKÇAK ka vazhduar të jetë anëtare aktive në zhvillimet e fundit brenda Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK).

Gjatë vitit 2019, Shoqata është ftuar të jetë pjesë edhe e Forumit Ndërkombëtar të FNK për Udhëheqësit e Departamenteve të Edukimit në Kontabilitet dhe Auditim. Forumi është pjesë e kornizës së angazhimit të akterëve relevantë në mënyrë që të gjithë të kontribuojnë në zhvillimin e strategjisë së FNK për avancimin e edukimit në kontabilitet dhe auditim duke identifikuar dhe prioritetizuar projektet, këshilluar mbi nevojat për rishikim të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit (SNE), si dhe për të identifikuar mundësitë për të bashkëpunuar drejt zhvillimit të diturive.

Në takimin e Këshillit të FNK i cili u mbajt në Kanada, ShKÇAK u përfaqësua nga Kryetarja e Këshillit të Shoqatës Znj. Afërdita Gashi dhe Drejtoresha Ekzekutive Znj. Ardiana Bunjaku. Sipas agjendës së takimit anëtarët e FNK përmes votave të tyre aprovuan parametrat e buxhetit për vitin 2019, raportin e auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare për vitin 2017, bazën e re të vlerësimit të kontributeve financiare nga anëtarësia dhe Strategjinë e FNK për 2019-2020. Më tutje takimi vazhdoi me raportin nga Komisioni për Nominime dhe anëtarët e FNK votuan për kandidatët e nominuar për pozitat e Kryetarit, Zëvendës Kryetarit dhe anëtarëve të rinj të Bordit. Paneli Këshillues mbi Pajtueshmërinë (CAP) i FNK mbikëqyrë dhe ofron këshilla për stafin

e FNK-së mbi implementimin dhe operimin e programit të pajtueshmërisë së anëtarëve dhe jep rekomandime tek Bordi i FNK-së mbi rishikimin e Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) dhe mbi pranimin e anëtarëve të rinjë. Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK znj. Ardiana Bunjaku e cila është anëtare e këtij paneli mori pjesë në takimet e mbajtura gjatë vitit 2019 ku u diskutuan çështjet e anëtarësisë duke përfshirë draft vlerësimet për pranimin e anëtarëve të rinj, ekzekutimi i strategjisë, ndryshimet që do të ndodhin në CAP dhe çështje lidhur me Bordin e Mbikëqyrjes së Interesit Publik (PIOB).

Në takimet e Komisionit për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit (PAODC) të FNK-së, ku Drejtoresha e ShKÇAK znj. Ardiana Bunjaku është Këshilltare Teknike, u diskutua rreth

ndihmës teknike nga PAODC për organizatat profesionale gjatë vitin 2019. Anëtarët e Komisionit shpalosën rezultatet e aktiviteteve të tyre në terren për t'i sjellur ato në vëmendje të FNK dhe për të ndërmarrë veprime të mëtutjeshme. Gjithashtu, gjatë këtij takimeve u diskutuan dhe çështje të tjera me rëndësi, si angazhimet dhe ngjarjet për vitin 2019, raporti i statusit global të adoptimit të standardeve për vitin 2019, qasja e re për avancimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit si dhe besimi dhe etika profesionale.

Anëtarët e Komisionit rishikuan planin vjetor për 2019 dhe definuan qasjen mbi planin vjetor për 2020. Gjithashtu u diskutua mbi Raportin e Statusit Global mbi Standardet Ndërkombëtare dhe mbi propozimin e grupit punues të Komisionit për të ardhmen e profesionit.

KONFERENCA ME TEMË - “ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT NË EKONOMITË NË ZHVILLIM”

Gjatë vitit 2019, FNK në partneritet me Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Bankën Botërore organizuan konferencën “Zhvillimi i Kapaciteteve të Kontabilitetit dhe Auditimit në ekonomitë në zhvillim” e cila është mbajtur në Malajzi. Konferenca kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave në fushën e financave publike midis vendeve me ekonomi të brishta dhe të prekura nga konfliktet.

Të ftuar nga Republika e Kosovës në këtë konferencë ishin Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK - Znj. Ardiana Bunjaku, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës - Z. Besnik Osmani,

Zëvendës-Auditori i Përgjithshëm - Z. Ilir Salihu, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit - Z. Ahmet Ismaili.

Përfaqësuesit nga Kosova para përfaqësuesve të shumë shteteve pjesëmarrëse në konferencë, prezantuan në panelin “Roli i Thesarit dhe Auditorit të Përgjithshëm në adresimin e sfidave të reformës në Menaxhimin e Financave Publike (MFP)” përvojat e Kosovës në dizajnimin dhe zbatimin e reformave në Menaxhimin e Financave Publike.

Panelistët nga Kosova prezantuan pikëpamjet e tyre lidhur rëndësinë e reformës në



menaxhimin e financave publike, mënyrën e koordinimit me palët tjera dhe theksuan aktivitetet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, Thesarit të Kosovës dhe Shoqatës si dhe kontributin e partnerëve nga organizatat ndërkombëtare dhe komuniteti i donatorëve.

Gjatë konferencës, Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK - Znj. Ardiana Bunjaku ishte paneliste edhe në panelin e diskutimit “Parimet dhe praktikrat e një Drejtori Ekzekutiv efektiv të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit”. Znj. Bunjaku shtjelloi me

shembuj praktik, parimet dhe praktikrat kyçe (duke përfshirë sfidat) që kontribuojnë në të qenurit një Drejtor Ekzekutiv efektiv në Organizatat Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit.

Panelistët gjithashtu prezantuan pikëpamjet e tyre lidhur me rëndësinë e rolit të një Drejtori Ekzekutiv në qeverisjen e mirë të një organizate, emërimin, parimet e ruajtjes së marrëdhënieve efektive dhe produktive me Bordin, marrëdhënieve me departamentet e zyrës ekzekutive si dhe vlerësimin e performancës.



SHKÇAK KONTRIBUESE AKTIVE NË POLITIKAT E KOMISIONIT EVROPIAN



Gjatë vitit 2019, ShKÇAK ka luajtur një rol aktiv në iniciativat e Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) për të kontribuar në proceset e ligjvënies në Komisionin Evropian përmes pjesëmarrjes në tryezat, pyetësorët, takimet e grupeve të ekspertëve, dhe konferencat e organizuara nga kjo Federatë.

Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK-së Znj. Ardiana Bunjaku mori pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) për vitin 2019, e cila u mbajt në Amsterdam, Holandë.

Ndër pikat e agjendës së takimit ishte prezantimi i raportit vjetor, diskutimi dhe aprovimi i planit të aktiviteteve

Korrik 2019 - Dhjetor 2020, aprovimi i pasqyrave financiare të audituara për vitin 2018, lirimi i Bordit të Drejtorëve të EFAA-s nga çdo detyrim që rrjedh nga kryerja e detyrave të tyre gjatë vitit financiar që përfundoi më 31 dhjetor 2018 si dhe caktimi i auditorit për 2019-2021.

Cjithashtu, gjatë këtij takimi u diskutuan dhe çështje të tjera me rëndësi, si planifikimi për vitin 2019 dhe projekt buxheti për vitin 2020, diskutimi mbi draft statutet e rishikuara të EFAA-së dhe hapat e ardhshëm. Pjesë e diskutimit ishte dhe zgjedhja e Presidentit të EFAA-së, ku u përzgjodh Z. Salvador Marin. Tryeza me titull “Kërkesat për raportim jo-financiar të NVM-ve: ndjekja e zhvillimit të drejtë dhe të qëndrueshëm” ku morën pjesë edhe përfaqësues të ShKÇAK, bashkoi

anëtarë të Parlamentit Evropian, përfaqësues të NVM-ve, ekspertë dhe profesionistë të kontabilitetit dhe auditimit, me qëllim të diskutimit të hapave të ardhshëm pas publikimit të raportit të EFAA-s i cili paraqet rezultatet e hulumtimit mbi kërkesat për raportim jo-financiar të NVM-ve në 14 shtete të Evropës. Pjesëmarrësit diskutuan se a duhet NVM-të të raportojnë mbi çështje jo-financiare siç është qeverisja dhe përgjegjësia e tyre ndaj ambientit dhe shoqërisë, si dhe kornizat raportuese që mund të përdoren për të raportuar mbi këto çështje.

Takimet e Grupit të Ekspertëve të Kontabilitetit dhe Grupit të Ekspertëve të Auditimit të EFAA u mbajtën në Amsterdam, Holandë.

Në takimin e Grupit të Ekspertëve të Kontabilitetit, ku ShKÇAK u përfaqësua nga z. Nazmi Pllana i cili është anëtar i këtij grupi, u diskutua rreth Planit të Punës 2019-2020, konsultimet e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), Grupit Këshillues për Raportim Financiar Evropian (EFRAG) dhe Komisionit Evropian dhe shqyrtimit gjithëpërfshirës të SNRF për NVM-të.

Gjithashtu, u diskutua edhe për projekte të

tjera që janë pjesë e Planit të Punës si raportimi jo-financiar i NVM-ve, pasuritë e paprekshme dhe raportimi i aktiviteteve kërkimore dhe zhvillimore të NVM-ve, si dhe cilësia e informacionit. Ekspertët e kontabilitetit gjithashtu diskutuan mbi zhvillimet e fundit në vendet anëtare.

Në takimin e Grupit të Ekspertëve të Auditimit, ku ShKÇAK u përfaqësua nga z. Lulzim Zeka i cili është anëtar i këtij grupi u diskutua mbi dokumentin e Bordit për Standarde Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (BSNAS/IAASB) mbi auditimin e entiteteve më pak komplekse, dhe Drafti i Ekspozimit të BSNAS/IAASB mbi Menaxhimin e Cilësisë.

Gjatë këtij takimi u diskutuan dhe çështje të tjera me rëndësi, ku grupi i ekspertëve të auditimit u përgjigj në dokumentin e grupit të monitorimit për propozimet e reformës për fuqizimin e qeverisjes dhe mbikëqyrjes së bordeve ndërkombëtare për përcaktimin e standardeve të auditimit në interes të publikut. Pjesë e diskutimit ishin dhe zhvillimet e fundit në vendet anëtare dhe takimi i radhës i grupit të ekspertëve të auditimit.



KONFERENCA NDËRKOMBËTARE TË EFAA-SË - “NDËRTIMI I PRAKTIKËS DIGJITALE”



Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të EFAA me temë “Ndërtimi i Praktikës Digjitale”, që është mbajtur në Amsterdam, Holandë.

Ndër pikat e agjendës së konferencës ishte azhurnimi mbi teknologjinë digjitale, lansimi i modelit të kompetencës digjitale të EFAA-së, fjalë rasti dhe ndarje e eksperiencës nga Femke Hogema - sipërmarrëse, praktikat që aplikohen në teknologjinë digjitale, përvetësimi dhe zhvillimi i talenteve dhe fjalimi përmbyllës nga Bodo Richard - President i EFAA-së.

PJESËMARRJA NË TAKIMIN E PËRGJITHSHËM TË FEDERATËS EVROPIANE TË KONTABILISTËVE DHE AUDITORËVE PËR NVM (EFAA) PËR VITIN 2019



Takimi tjetër i Përgjithshëm i EFAA për vitin 2019 u mbajt në Bruksel ku morën pjesë Kryetarja e Këshillit të ShKÇAK Znj. Afërdita Gashi dhe Drejtoresha Ekzekutive Znj. Ardiana Bunjaku. Takimi shënoi 25 vjetorin e EFAA dhe ndër pika të agjendës së takimit ishte diskutimi dhe aprovimi i draftit të rregulloreve të brendshme të EFAA-së dhe diskutimi i Strategjisë së EFAA-së për vitin 2019 dhe rezultatet e pyetësorit të evaluimit.

Gjatë qëndrimit në Bruksel, përfaqësueset e ShKÇAK morën pjesë në ngjarjen e përbashkët të Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) dhe Accountancy Europe me temë “Roli i profesionit në nevojat për zhvillim të NVM-ve”. Panelistët në këtë ngjarje diskutuan se si NVM-të në Evropë po përballen me digjitalizimin e shpejtë, duke ndryshuar pritjet e akterëve relevant, tregun në lëvizje si dhe presionin intensiv për të arritur vetë qëndrueshmërinë. Gjatë panelit u ngritën çështje se si mund të ndihmojë profesioni i kontabilitetit dhe auditimit që sektori i NVM-ve të zhvillojë ndryshimet e lartë cekura dhe se a është e nevojshme që kontabilistët dhe auditorët profesionistë të ndryshojnë aftësitë dhe shërbimet e tyre për të përmbushur nevojat në zhvillim të NVM-ve.

SHKÇAK ANËTARE AKTIVE E FEDERATËS MESDHETARE TË KONTABILISTËVE (FCM)



ShKÇAK vazhdon të jetë anëtare aktive në Federatën Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM). Gjatë vitit 2019, në fokus të FCM ishte pyetësi për zhvillimin e një manuali të Menaxhimit të Cilësisë për shërbimet jo audituese i cili u finalizua gjatë vitit.

Mbledhja e Këshillit të FCM u mbajt në Lisbonë, Portugali ku ShKÇAK u përfaqësua nga Kryetarja e Këshillit znj. Afërdita Gashi dhe Drejtoresha Ekzekutive znj. Ardiana Bunjaku. Takimit të Këshillit të FCM i parapriu një takim i grupit punues për Kontrollin e Cilësisë i përbërë nga anëtarë të FCM të cilët diskutuan rreth pyetësorit të FCM-së mbi Kontrollin e Cilësisë.

Mbledhja e Përgjithshme e Asamblesë së FCM u mbajt në Marakesh të Marokut ku ShKÇAK u përfaqësua nga Kryetarja e Këshillit znj. Afërdita Gashi. Ndër pikat e agjendës së këtij takimi ishte rishikimi i buxhetit për vitin 2019 në lidhje me kontributet financiare të anëtarëve të FCM, aprovimi i raportit vjetor

dhe raportit të pasqyrave financiare të audituara për vitin 2018.

Gjithashtu, gjatë takimit u diskutua mbi azhurnimin e grupit punues për Kontrollin e Cilësisë të shërbimeve jo audituese, aktivitetet që nga takimi i fundit i mbajtur në Lisbonë, organizimi i konferencës së ardhshme vjetore, takimet e ardhshme dhe çështje të tjera me rëndësi.

Mbledhja tjetër e Asamblesë së FCM u mbajt në Madrid të Spanjës ku ShKÇAK u përfaqësua nga Zv. Drejtori i ShKÇAK Z. Driton Pustina. Gjatë takimit u mbajtën zgjedhje për Presidentin, Zv Presidentin dhe Thesaristin për mandatin nga data 01 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2021. Ndër pikat e agjendës së takimit ku u diskutuan politikat ndërkombëtare ishin: analiza e situatës ndërkombëtare të profesionit si dhe diskutimi i njohjes ndërkombëtare nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilitetit dhe Auditimit (IFAC). Gjithashtu, gjatë këtij takimi u diskutuan dhe çështje të tjera me



rëndësi, si aprovimi i buxhetit për vitin 2020 dhe vendndodhjet dhe datat e takimeve të ardhshme.

Në vijim të mbledhjes së përgjithshme u mbajt edhe Konferenca Vjetore e FCM me temë: “Implementimi i Kontrollit të Cilësisë për Shërbime Jo-Audituese”. Konferenca u hap me fjalë mirëseardhje nga Dr. José María Casado - Anëtar i Komisionit të Përhershëm

në Këshillin e Përgjithshëm të Ekonomistëve të Spanjës (CGE), ndërsa fjalë hyrëse mbajti Z. Philippe Arraou - President i FCM.

Ndër pikat e agjendës ishte dhe Prezantimi i Udhëzuesit të FCM për Implementimin e Kontrollit të Cilësisë për shërbime jo-audituese dhe sfidat në të cilat mund të hasin shtetet gjatë implementimit të Kontrollit të Cilësisë për këto shërbime.



SHKÇAK VIJON PJESËMARRJEN NË PROGRAMET E QENDRËS PËR REFORMA NË RAPORTIM FINANCIAR



Si pjesë e Qendrës për Reforma në Raportimin Financiar (QRRF) të Bankës Botërore, përfaqësuesit e ShKÇAK-së në vazhdimësi kanë qenë pjesë e seminareve dhe punëtorive të organizuara nga kjo qendër.

Përfaqësues të ShKÇAK-së morën pjesë në punëtorinë e edicionit të 4-të të Komunitetit për Edukim Profesional (EduCoP), i cili është organizuar nga Qendra e Ekselencës së Financave (QEF), në Lubjanë. Punëtorja dyditore mbledhi përfaqësues nga Universitetet dhe Organizatat Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit (OPK) për të shqyrtuar më tej zhvillimin cilësorë të Kontabilitetit dhe Auditimit të Sektorit Publik, në vendet pjesëmarrëse.

Cjatë ditës së parë të punëtorisë, përveç Fondit Monetar Ndërkombëtarë i cili paraqiti dokumentin e tij mbi Zbatimin e Kontabilitetit Akruar në Sektorin Publik, pjesëmarrësit konsideruan faktorët në zhvillimin e anëtarësimit në OPK për kontabilistët dhe auditorët e sektorit publik. Punëtorja po ashtu përfshiu një sesion pune ku pjesëmarrësit patën mundësi të shtrojnë pyetje specifike në lidhje me Trajnimin e Trajnerëve (ToT) dhe të hyjnë në grupe për të përmirësuar më tej strategjinë dhe planet e veprimit në nivel të vendit (SPVV) për t'u përgatitur për rolin e ToT të planifikuar për fazën e dytë të programit PULSAR.

Përfaqësuesja e ShKÇAK-së Z. Ardiana Bunjaku prezantoi para pjesëmarrësve strategjinë dhe planet e veprimit në nivel të vendit (SPVV) për rolin e ToT në Kontabilitetin dhe Auditimin e Sektorit Publik në Kosovë.

Cjatë ditës së dytë të punëtorisë, para pjesëmarrësve u prezantua modeli i përjashtimit i aplikuar në kornizën e kualifikimit të ACCA-së, u paraqit modeli i pasqyrave financiare të IPSAS të zhvilluara kohët e fundit



nga Ernst and Young GmbH dhe u diskutua implementimi i këtij materiali udhëzues. Në këtë sesion pjesëmarrësit po ashtu fituan njohuri më shumë rreth programeve dhe burimeve në dispozicion përmes Qendrës së Ekselencës në Financat.

Në punëtorinë dy ditore të Komunitetit të Praktikës për Raportim Financiar me temë “Vlerësimi i Implementimit të Reformës dhe Planifikimi për të Ardhmen”, e cila u mbajt në Vjenë, Austri, morën pjesë përfaqësues të ShKÇAK, Ministrisë së Financave dhe Këshillit Kosovar për Raportim Financiar. Objektivi i kësaj punëtorie të Komunitetit të Praktikës të Raportimit Financiar ishte të sigurojë një diskutim interaktiv për zbatimin e reformave në kontabilitet dhe auditim, i cili mbështet zhvillimin e kornizave të harmonizuara me ‘acquis communautaire’ të Bashkimit Evropian dhe ndërtimin e kapaciteteve në raportimin financiar në vendet e Ballkanit Perëndimor. Bashkangjitur është agjenda e punëtorisë.

Sesioni i “Trajnimit e Trajnerëve” i organizuar në kuadër të programit për kontabilitet dhe raportim financiar të sektorit publik – PULSAR mbledhi përfaqësues të Qeverive, Universiteteve si dhe Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Partneritetit Lindor të BE. Sesioni ishte

një bashkëpunim i ACCA dhe Qendrës për Reforma në Raportim Financiar (QRRF) e cila është pjesë e Bankës Botërore. Një grup i trajnimit u mbajt në Vjenë nga 7-11 tetor, 2019 dhe një grup u mbajt në Tiranë nga 11-15 nëntor.

Qëllimi i trajnimit ishte të përgatisë trajnerët rreth temës së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS). Në Tetor 2017, ACCA publikoi një raport mbi implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP): statusi aktual dhe sfidat, një ekzaminim i gjendjes aktuale të adoptimit të SNKSP në të gjithë botën. Raporti shqyrton progresin e bërë si dhe sfidat aktuale në implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik. Duke marrë në konsideratë adoptimin e SNKSP në një gamë të gjerë të vendeve në zhvillim dhe duke identifikuar të përbashkëtat dhe çështjet në zhvillim, raporti nxori në pah mësimet si nga përfitimet ashtu edhe nga sfidat që lidhen me adoptimin e SNKSP.

Përfaqësues të ShKÇAK dhe Këshillit Kosovar për Raportim Financiar morën pjesë në punëtorinë dy ditore të Komunitetit të Praktikës për Raportim Financiar me temë “Roli i Profesionit të Kontabilitetit dhe Auditimit në modernizimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor”, e cila u mbajt në Vjenë, Austri.

Objektivi i kësaj punëtorie të Komunitetit të Praktikës të Raportimit Financiar ishte të sigurojë një diskutim interaktiv për zbatimin e reformave në kontabilitet dhe auditim, i cili mbështet zhvillimin e kornizave të harmonizuara me ‘acquis communautaire’ të Bashkimit Evropian dhe ndërtimin e kapaciteteve në raportimin financiar në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Diskusimet ishin tematike dhe do të ndihmojnë në përcaktimin e aktiviteteve të ardhshme për Programin REPARIS për NVM. Punëtorja mbledhi pjesëmarrës nga 6 vende të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia).

STUDENTËT E VITIT

ShKÇAK në vazhdimësi vlerëson përkushtimin dhe disiplinën që tregojnë anëtarët e Shoqatës gjatë ndjekjes së programeve çertifikuese. Edhe për vitin 2019, gjatë festës së fund vitit janë ndarë çmimet për Studentët e vitit si mirënjohje për rezultatet e arritura nga këta studentë, por edhe si inkurajim për studentët e tjerë për të vazhduar me përkushtimin e tyre drejt përfitimit të thirrjeve profesionale që ata i aspirojnë.




1. NIVELI "AUDITOR I ÇERTIFIKUAR"
- DAFINA IMERI

2. NIVELI "KONTABILIST I ÇERTIFIKUAR"
- SHQIPTON SELIMI




3. NIVELI "TEKNIK I KONTABILITETIT"
- MIRËENZA KASTRATI

4. NIVELI "AUDITOR I BRENDSHËM I ÇERTIFIKUAR"
- GRESA SHEHU KIKA




5. NIVELI "EKSPERT I LICENCUAR I FORENZIKËS FINANCIARE"
- LIRIDON RAMA

6. NIVELI "EKSPERT I LARTE TATIMOR"
- ALBAN BACAJ



7. NIVELI "EKSPERT TATIMOR"
- KUSHTRIM VLLASA

STRUKTURA ORGANIZATIVE



RAPORTET E KOMISIONEVE

Komisionet e ShKÇAK-së janë shtylla të rëndësishme në qeverisjen e Shoqatës dhe luajnë rol kyç në arritjen dhe zhvillimin e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve të Shoqatës dhe përmbushjen e objektivave të Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK-së.

Komisionet e Shoqatës i përcjellin zhvillimet në fushat përkatëse të profesionit në vend dhe në botë dhe angazhohen që objektivat dhe aktivitetet e Shoqatës t'i reflektojnë ato zhvillime në shërbim të interesit publik. Komisionet shërbejnë si urë lidhëse në mes të anëtarëve dhe akterëve relevantë të profesionit në krijimin e një mjedisi të avancuar të punës për kontabilistët dhe auditorët.

Në anën tjetër, Komisionet e ShKÇAK-së përkujdesen për ruajtjen e integritetit profesional të anëtarëve, respektimin e Kodit të Etikës nga ata dhe pajtueshmërinë e punës së tyre me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit, si dhe të edukimit.

RAPORT NGA KOMISIONI PËR NOMINIME


Të nderuar Anëtarë,

Një nga proceset dhe aktivitetet e rëndësishme brenda Shoqatës është procesi zgjedhor që fillon me nominimin e anëtarëve për organet e Shoqatës dhe përfundon me votimin tuaj në Mbledhjen e Përgjithshme. Vota e juaj, anëtarë të nderuar, përcakton se kush nga anëtarët e Shoqatës, kolegë tuaj do të jetë pjesë e këtyre organeve të cilat në emër të Asamblesë do ta udhëheqin Shoqatën dhe do të jenë përgjegjës për realizimin e Strategjisë së saj.

Kush do të jetë anëtar i Këshillit apo anëtar i Komisioneve varet nga vet ju, respektivisht nga nominimi i juaj dhe nga besimi i juaj se për cilin anëtar jeni përcaktuar. Në anën tjetër, nga numri i nominimeve krijohet edhe mundësia më e madhe e përzgjedhjes dhe juve ju krijon hapësirë që nga një numër më i madh të zgjidhni ata që ju konsideroni se mund të kontribuojnë më shumë.

Brenda këtij viti raportues janë zgjedhur anëtarët e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë. Komisioni për nominime përmes planit të punës e ka përcaktuar zhvillimin e këtyre zgjedhjeve duke u mbështetur në Statutin e Shoqatës dhe Rregulloren e Komisionit. Komisioni për nominime çdo herë kur zgjedhjet janë të parapara kujdeset që anëtarët të jenë mirë të informuar për të gjitha detajet dhe kriteret që duhet të përmbushen për tu nominuar.

Brenda afatit të përcaktuar për nominime, komisioni ka pranuar gjithsej 19 nominime përmes të cilave janë nominuar dhjetë (10) anëtarë për komisionin për Sjellje dhe Disiplinë. Të gjithë anëtarët e nominuar i kanë



plotësuar kriteret e përcaktuara dhe konform Rregullores së Komisionit për nominime janë ftuar në intervistë në të cilën i kanë shpalosur pikëpamjet e tyre por edhe propozimet apo formën më të mirë përmes të cilës ata do të japin kontributin e tyre.

Nga dhjetë anëtarët e nominuar para procesit të intervistimit, pesë prej tyre kanë deklaruar tërheqjen e tyre. Komisioni për nominime, pas përfundimit të intervistave ka përgatitur rekomandimin për Asamble respektivisht listën e kandidatëve të cilët me votën tuaj u zgjedhën anëtarë të Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë të cilët do ta ushtrojnë këtë detyrë për tre vitet e ardhshme.

Nominimet për anëtarë të Këshillit, 2020

Në kuadër të përgatitjeve për nominimet për anëtarë të Këshillit për vitin 2020, Komisioni për nominime në fund të viti 2019 ka mbajtur mbledhje në të cilat janë përcaktuar hapat për zhvillimin e procesit të nominimeve.

Komisioni në këtë mbledhje e aprovoi ftesën për nominime si dhe planin e punës

së komisionit. Gjithashtu, u përcaktua edhe datë e dërgimit të ftesës tek anëtarët dhe po ashtu komisioni vendosi që krahas mundësisë për dorëzimin fizik të nominimeve ato të dërgohen edhe në formë elektronike.

Duke e ditur rëndësinë e procesit të nominimeve si dhe rëndësinë dhe rolin e

anëtarëve të Këshillit, Komisioni nga ky takim udhëzoi që bashkangjitur më ftesën për nominime të dërgohet një mesazh në të cilin do të theksohet roli dhe rëndësia e të qenit anëtar i Këshillit. Procesi i nominimit dhe të gjitha aktivitetet tjera përcjellëse të Komisionit të Nominimeve do të zhvillohen gjatë vitit 2020.

Afërdita Gashi

Kryesuese e Komisionit për Nominime

RAPORT NGA KOMISIONI PËR SJELLJE DHE DISIPLINË

Të nderuar Anëtarë,

Etika profesionale është parimi bazë i çdo anëtari të SHKÇAK, ajo duhet të jetë e gravuar në zemrën dhe në mendjen e secilit anëtarë dhe të qëndroi aty pa marr parasysh ndryshimet digjitale dhe presionet e trendeve globale. Etika është pjesë integrale e profesionit tonë, pra, jo vetëm që është një atribut por është baza mbi të cilën ndërtohet profesioni.

Gjatë vitit që lam pas, kemi shënuar 10 Nëntorin - ditën ndërkombëtare të kontabilistit, dhe duke u nisur nga ajo që u theksua më lartë, rëndësisë së lartë të Etikës në profesionin e kontabilistit dhe auditorit, ne nuk kemi gjetur temë më të mirë se kjo për ta shënuar këtë ditë. Andaj komisioni i etikës në bashkëpunim me ZE kanë organizuar Panel Diskutimi me temën -“Rëndësia e Etikës në Zhvillimin e Profesionit “ , gjithashtu është organizuar edhe seminari i edukimit të vazhdueshëm profesional me temën - “Kodi i Etikës së IESBA 2019” (edicioni I fundit)

Në panelin diskutues kanë marr pjesë përfaqësuesit e Institucioneve kyçe që ndërlidhen me profesionin e Kontabilistëve dhe Auditorëve, e që janë ATK, FIC, Oda Amerikane, Autoritetit Rregullues i Konkurrencës , Agjencia Kosovare e Biznesit. Qëllimi i këtij paneli ka qenë këmbimi i eksperiencave në raport me atë se ku qëndrojnë institucionet e tyre me etikën profesionale, të identifikoj sfidat për implementimin e Kodit të Etikës, gjithashtu të diskutohet se si Etika ndikon në rritjen e besueshmërisë në raport me palët e treta. Një gjë tjetër që ka zënë vend në këtë panel diskutimi ka qenë edhe promovimi i rëndësisë së raportimit të shkeljeve etike jo vetëm për anëtarët e shoqatës tone mirëpo



edhe për zyrtarët e tjerë të sektorit publik dhe privat, ku është theksuar se akte të tilla të raportimit do të ndikojnë jo vetëm në rritjen e cilësisë së raportimit financiar, por edhe në të mirë të interesit të përgjithshëm kombëtar. Duke u nisur nga roli vital që një kontabilist dhe auditorë ka në një organizatë është shumë e rëndësishme që ETIKA të mirëmbahet përmes edukimit të vazhdueshëm profesional, andaj kemi organizuar edhe një seminar të tillë me temën “Kodi i Etikës së IESBA 2019”, ku janë trajtuar pikat si dallimi në mes të kodit të ri dhe atij të kaluar, kërkesat kryesore lidhur me parimet themelore dhe pavarësisë së auditorit etj.

Komisioni për hetim dhe disiplinë gjatë vitit 2019 ka diskutuar dhe shqyrtuar rastet me dy anëtarësi, kur anëtarët e shoqatës tonë janë anëtar edhe në shoqata të tjera të kontabilitetit. Kështu ky komision ka kërkuar që të ju drejtohet një pyetësor të gjithë anëtarëve për të deklaruar nëse ata janë anëtarë edhe në shoqata të tjera brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu i' u është dërguar rekomandim komisionit për nominime që të mos nominojnë anëtarë në këshill dhe në komisione, nëse këta persona janë anëtarë

edhe në shoqata të tjera në Kosovë.

Në vitin 2019 nuk është paraqitur ndonjë rast i shkëljes së këtij Kodi nga ana e anëtarëve të shoqatës. Ne besojmë se anëtarët tonë po veprojnë nën betimin që e kanë dhënë përmes “Deklaratës nën Betim” për të shërbyer mbi 5 parimet e Etikës e që janë integriteti, objektiviteti, kompetenca profesionale, konfidencialiteti si dhe sjellja profesionale.

Për Etikën mund të themi se është njësi matëse me të cilën vlerësohet besimi, andaj që të jemi vazhdimisht Etik, shoqata i mbështetë anëtarët e vet duke i ofruar këshilla profesionale sa herë ata gjenden para dilemës nëse një veprim është etik ose jo etik. Një profesionist gjatë karrierës së tij është e pamundur të mos sfidohet në aspektin e etikës, andaj ftoheni që këto dilema t’i adresoni tek shoqata dhe kështu së bashku ti trajtojmë ato.

Me hyrjen në fuqi të udhëzimit administrativ 07/2019 dhe 01/2020 të Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, rritet përgjegjësia e kontabilistëve të çertifikuar dhe shtohen kërkesat ligjore për rishikim ,rrjedhimisht rritet barra e anëtareve tanë. Ne kemi konsideruar se duhet të rrisim akoma promovimin e etikës profesionale. Roli i këtij komisioni gjatë kësaj periudhe do të jetë rol pro aktiv, andaj promovimi i kodit me qëllim të parandalimit të rasteve jo etike konsiderojmë se është rruga me e drejtë që duhet ta ndjekim. Për ta arritur këtë qëllim ne si komision në bashkëpunim me ZE kemi

planifikuar aktivitete te ndryshme siç janë organizimi i një tryeze diskutimi me bizneset dhe takime me institucione tjera, gjithashtu kemi propozuar mbajtjen e një ligjërate të shkurtë mbi etikën të përfshihet në pjesën e mirëseardhjes për anëtarët e rinj dhe aktivitete te tjera.

Për t’ju dalë në ndihmë dhe për t’i mbështetë anëtarët tanë, komisioni për sjellje dhe disiplinë gjatë vitit 2020, do të përpiloj një anketë ku do t’iu drejtohet anëtarëve për bashkëpunim, me qëllim që ata t’i shprehin të gjitha sfidat etike në procesin e punës. Komisioni për sjellje dhe discipline, do të hartoj një raport nga ky anketim, dhe do t’i adresoj problemet e anëtarëve tanë.

Çdo shkëlje etike që mund të bëhet e dëmton jo vetëm reputacionin e personit që e ka kryer atë, por e dëmton edhe reputacionin e shoqatës. Andaj ftoj anëtarët e ShKÇAK që gjatë ushtrimit të profesionit të sillen me përgjegjësi të plotë ndaj profesionit, ndaj anëtarëve të tjerë dhe ndaj shoqatës, sepse shoqata është e anëtarëve, ajo është familja jonë e madhe.

Elvira Ibrahim Hoti

Kryesuese e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë

RAPORT NGA KOMISIONI PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË PAJTUESHMËRI ME STANDARDET


Të nderuar anëtarë,

Viti 2019 ishte një vit i zhvillimeve intensive dhe sfidave në aspektin e menaxhimit të cilësisë në pajtueshmëri me standardet bazuar në Ligjin e ri për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Komisioni për menaxhim të cilësisë në pajtueshmëri me standardet është themeluar me qëllim të sigurimit të implementimit të objektivave të SHKÇAK-së, nga fusha e menaxhimit të cilësisë pajtueshmëri me standardet përmes përcaktimit të kompetencave, detyrave dhe përgjegjësisive. Qëllimi kryesor i Komisionit dhe Departamentit të Menaxhimit të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet gjatë vitit 2019 ishte vazhdimësia e implementimit të Rregullores së menaxhimit të cilësisë në pajtueshmëri me standardet. Ndërsa kjo rregullore ka për qëllim të siguroj se të gjithë anëtarët e SHKÇAK të angazhuar në ofrimin e shërbimeve profesionale veprojnë në pajtim me:

- :: Standardet më të larta etike;
- :: Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA); dhe
- :: Sigurojnë se ofrimi i shërbimeve të tyre është në pajtim me kërkesat e Kodit të Etikës të FNK-së.

Duke u bazuar në planin strategjik dhe planin e punës së SHKÇAK-së, aktivitetet e ndërmarra gjatë vitit 2019 ishin: (i) kontrollet



e realizuara për sigurimin e pajtueshmërisë me standardet e profesionit për angazhime të auditimit të auditorëve, (ii) raportet e vlerësimit, (iii) përzgjedhja e auditorëve për menaxhim të cilësisë së ciklit të tretë, (iv) shqyrtimi i propozimeve për ndryshime në punën e departamentit të menaxhimit të cilësisë në pajtueshmëri me standardet, (v) aprovimi i pyetësorit të azhurnuar për auditor dhe krijimi i pyetësorit për kontabilist të çertifikuar, si dhe (vi) hulumtimi për etikë dhe tarifa të ulëta të auditimit i cili do të publikohet gjatë vitit 2020.

Në këtë drejtim, si prioritet tjetër i këtij komisioni dhe departamenti, gjatë vitit 2019 ishte bashkëpunimi me KKRF-në dhe Bordin e Mbikëqyrjes Publike i themeluar në Maj të po këtij viti, në mënyrë që mbikëqyrja publike e auditorëve të jetë sa më efikase dhe efektive dhe të rezultojë në ngritjen e cilësisë së këtij profesioni.

Për faktin që auditorët ligjor janë profesionistë të pavarur, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit Nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim

Financiar dhe Auditim i cili shfuqizoi ligjin paraprak për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, si dhe duke vlerësuar rolin dhe kontributin e tyre në mbrojtjen e interesit publik nëpërmjet zbatimit të drejtë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) si dhe respektimit të kërkesave të cilat dalin nga Kodi i Etikës për Auditorët Profesioniste të FNK-së, Departamenti i menaxhimit të cilësisë në pajtueshmëri me standardet gjatë vitit 2020 do të vazhdojë implementimin e rregullores së menaxhimit të cilësisë në pajtueshmëri me standardet të profesionit.

Departamenti i menaxhimit të cilësisë në pajtueshmëri me standardet do të vazhdojë mbajtjen e takimeve me anëtarët e ShKÇAK dhe rishikimin e pajtueshmërisë së punës së tyre me standardet e angazhimeve të

auditimit dhe kontabilitetit. Duke u bazuar në të gjeturat gjatë rishikimeve dhe kërkesave të anëtarëve, do të propozohen tema të EVP-ve të cilat do të kenë për qëllime ngritjen e cilësisë së shërbimeve të auditimit dhe shërbimeve të kontabilitetit.

Në fund, më lejoni të falënderoj Departamentin e menaxhimit të cilësisë në pajtueshmëri me standardet për punën e realizuar gjatë vitit 2019 në fushën e menaxhimit të cilësisë, duke kontribuar kështu në realizimin e misionit të ShKÇAK-së për mbrojtje të interesit publik.

Po ashtu një falënderim i veçantë ju shkon të gjithë auditorëve të përzgjedhur për rishikim, të cilët kanë bërë një punë të palodhshme në këtë drejtim, duke bashkëpunuar gjatë gjithë kohës me Departamentin e menaxhimit të cilësisë në pajtueshmëri me standardet.

Shpresa Mustafa

Kryesuese e Komisionit për Menaxhim të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet

RAPORT NGA KOMISIONI PER STANDARDE PROFESIONALE

Të nderuar Anëtarë,

Komisioni për standarde profesionale gjate këtij viti ka realizuar disa aktivitete domethënëse, duke analizuar efektet që vijnë nga standardet e reja dhe implementimi i tyre në Kosovë dhe duke kërkuar që të organizohen trajnime për këto standarde IFRS 16, IFRS 15, IFRS 9 dhe në këtë mënyrë kontabilistët dhe auditorët do të jenë të informuar me ndikimin e këtyre standardeve në raportim financiar.

Një nga proceset dhe aktivitetet më të rëndësishme brenda Shoqatës te realizuara nga komisioni për standarde profesionale gjate këtij viti ishte angazhimi i ShKCAK në mbështetje të Zyrës së OJQ-ve në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike në draftimin e Udhëzimit Administrative QRK - Për Regjistrimin, Funksonimin dhe Çregjistrimin e Organizatave Joqeveritare. Dhe në kuadër të këtij angazhimi ShKCAK mori përsipër që të përpiloj formatin për raportim financiar për OJQ-të duke krijuar një standard unik dhe gjithëpërfshirëse për të gjitha OJQ-të duke u bazuar ne Standardin Ndërkombëtarë për Raportim Financiare SNRF për NVM. Me implementimi e këtij udhëzimi administrativ për herë të parë në Kosovë do të jetë i rregulluar raportimi financiar i OJQ-ve ku të gjitha OJQ-te do raportojnë ne format te unisuar. E gjithë kjo do këtë ndikim pozitiv në vetë operimin më funksional te zyrës për OJQ në Ministrinë e Administratës Publike për të bërë të mundur një monitorim më të mirë dhe të drejtë për të gjitha OJQ-të. Me realizimin e ketij formati të raportimit financiar do rritet transparencja dhe siguria e raportimit financiare të OJQ-ve dhe kjo do i ndihmoj të gjitha palëve te interesit për të bërë të mundur qe të bëjnë analiza më konkrete ne aktivitetet



e OJQ-ve dhe shërbime te tyre, dhe po ashtu do lehtësoj edhe punën e Administratës Tatimore në raport me OJQ-të. Po mbi te gjitha ky format i raportimit financiare do jete një ndihmës shume e madhe për vete OJQ-te pasi qe përfundimisht do e kenë te zgjedhur formën e raportimit financiare qe do jete i pranuar nga te gjithë palët e interesit dhe nuk do kenë dilema dhe kokëçarje se si do duhet përgadisni raportimin e financiare dhe çfarë standardesh te përdorin per te bere regjistrimet kontabël dhe te përgaditjes te raporteve financiar te tyre.

Me këtë veprim SCAAK ka përmbushur edhe një nga objektivat e saj si Organizatë joqeveritare për te ndihmuar dhe ndikuar ne përmasimin e gjendjes ne shoqëri. Dhe për me tepër SCAAK është një nga OJQ-te profesionale qe i takon grupit te OJQ-ve te regjistruara ne këtë zyre. Ne këtë mënyrë SCAAK ka treguar profesionalizimin dhe përgjegjësin social. Për me tepër, do duhet cekur qe e gjithë angazhimi i ofruar nga SCAAK ne këtë projekt ka qene pa pagese, ku ekspertet e angazhuar nga SCAAK me pune vullnetare pa pagese kan bere te mundur qe te realizohet ky projekt.

RAPORT NGA KOMISIONI PËR EDUKIM PROFESIONAL

Të nderuar anëtarë,

Në kohën kur profesioni i kontabilistit dhe auditorit është duke u ballafaquar me sfida të mëdha, që nga ndryshimet në standarde të raportimit financiar dhe auditimit e deri te nevoja e menjëhershme e digjitalizimit, ShKÇAK ka arritur të mbajë këtë tempo duke arritur të reflektoj këto si në programin çertifikues po ashtu edhe përmes edukimit të vazhdueshëm profesional.

Në vitin që e lamë pas, Komisioni i Edukimit në bashkëpunim me zyrën ekzekutive dhe departamentin e standardeve dhe edukimit ka punuar në drejtim të përmbushjes së strategjisë së ShKÇAK në fushën e edukimit në pajtueshmëri me DOA dhe me nevojat aktuale të anëtarësisë për certifikime të specializuara.

Komisioni i Edukimit ka për detyrë të ndjekë çfardo ndryshime në standarde dhe legjislacion dhe të rekomandojë zyrën ekzekutive dhe Këshillin e ShKÇAK të adresojë ato. Në këtë mënyrë Shoqata ka azhurnuar materialet studimore të lëndëve të Tatimeve, Raportimit Financiar, Auditimit si dhe ka përfshirë në programin vjetor të edukimit të vazhdueshëm profesional, tema relevante për ruajtjen dhe azhurnimin e njohurive dhe aftësive të anëtarëve tanë.

Në këtë mjedis të ndryshueshëm, Komisioni i Edukimit tashmë ka filluar të vlerësoj trendet globale në edukimin profesional që drejtpërdrejt lidhen me shërbimet që anëtarët tanë ofrojnë për publikun ose punëdhënësit dhe është duke përpiluar një strategji të



rishikimit të kompetencave profesionale të nevojshme. Në këtë aspekt, Komisioni i Edukimit ka shqyrtuar mundësitë e ndryshme për të iu ofruar studentëve mësim praktik në përdorimin e softuerëve të ndryshëm të kontabilitetit si dhe në digjitalizimin e procesit të trajnimit përbrenda Shoqatës.

Komisioni për Edukim Profesional mbetet i përkushtuar të ndihmojë në zbatimin e të gjitha kërkesave nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit për Kontabilist si dhe përmbushjes së çfardo kërkesë të drejtpërdrejt të tregut.

Lulzim Zeka

Kryesues i Komisionit për Edukim Profesional

RAPORT NGA KOMISIONI PER TATIME

Të nderuar Anëtarë,

Komisioni i tatimeve është pjesë e strukturës organizative të komisioneve profesionale pranë SHKÇAK. Komisioni i Tatimeve gjatë vitit 2019, ka vepruar në pajtim me Rregulloren e Komisionit për Tatime të aprovuar nga Këshilli i SHKÇAK, me Planin e aprovuar të punës, si dhe kërkesave nga palët e interesit .

Komisioni ka qenë i angazhuar në tri fusha të rëndësishme nga përgjegjësia e tij :

Pjesëmarrja pro aktive në diskutimet publike për ndryshimet e parapara në tri draft -ligjet tatimore , TVSH ,TAK dhe TAP si dhe Draft Ligjin për Administratën tatimore dhe Procedurat. Pjesëmarrja aktive në takimet me palët e interesit ku ShKÇAK është anëtar si Oda ekonomike Amerikane përmes Komitetit të Tatimeve, USAID dhe ATK etj.

Mbajtja e kontakteve me anëtarësinë e Shoqatës, raportimi në Këshillin e Shoqatës, dhe bashkëpunimi me Komisionet tjera në Shoqatë.

Komisioni i Tatimeve gjate vitit 2019 ka mbajtur 2 takime të rregullta, takime me anëtarësi përmes tryezave si dhe disa takime tjera dhe pjesëmarrje në tryeza me palët e interesit.

Në bazë të kërkesave të Ministrisë së Financave nga janari i vitit 2019 për dhënie të komenteve në Projekt Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat , Komisioni i tatimeve në janar 2019 ka përcjellë te anëtarët draft Ligjin duke kërkuar komente e propozime për çështje me interes në profesion dhe administrim tatimor.

Duke marrë parasysh se disa prej shumë komenteve të dhëna nga Komisioni i Tatimeve ishin marrë parasysh nga Ministria e Financave , përfshirë zgjatjen e kontrollit,



kufizimin e llogaritjes së interesit, pastaj riaktivizimin e bordit, mos përfshirja e të njëjtit inspektor dhe mbikëqyrësve në rastin e ri kontrollit, Komisioni në janar të vitit 2019 ka hartuar komente shtesë në draft Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe atë rreth këtyre temave:

1. Përkufizimin “Barrë” apo” peng”
- 2.Përkufizimin “vlerë e hapur e tregut”
- 3.Vendimet shpjeguese individuale të publikohen si praktikë duke ruajtur konfidencialitetin e tatimpaguesit
- 4.Llogaritjes të interesit në baza ditore e jo mujore
- 5.Transaksionet e këmbimit në kontratat e ndërtimit, ku është kërkuar që momenti i detyrimit të përcaktohet në bazë të parimit aktual e jo në bazë të kontratave të nënshkruara
6. Ndëshkimet në bazë të qarkullimit të interpretohen saktë
- 7.Lehtësira të ndëshkimeve me rastin e rivlerësimeve tatimore , në rastet kur tatimpaguesi pajtohet me rivlerësim dhe hjek dorë nga ankesa
8. Propozim që në rastet kur Gjykata vendos me një aktvendim për një çështje të ngjashme,

Departamenti i Ankesave të vendos ngjashëm si një praktikë e vendosjes.

Këto komente janë dërguar në Oden Ekonomike Amerikane, ATK dhe në Ministrinë e Financave.

Komisioni i Tatimeve si pjesë e strukturave të SCAAK ka dhënë kontribut në organizimin e Tryezës rreth Komenteve mbi Draft Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Në tryeza të organizuara nga ATK dhe USAID janë kërkuar që gjatë ruajtjes së integritetit të ATK-se të merren parasysh komentet e Komisionit të Tatimeve dhe Shoqatës në përgjithësi që kanë të bëjnë me sjelljen e zyrtarëve tatimor gjatë aktiviteteve përmbushëse, ngritje të vetëdijes së tatimpaguesve, konsumatorëve dhe popullatës në luftimin e ekonomisë ilegale , luftimin e korrupsionit , madje duke kërkuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit të vendosin që në kuadër të lëndës mësimore të edukatës qytetare nëpër shkolla të mësohet edhe për edukimin fiskal në mënyrë që nxënësit qysh në bankat e shkollës fillore të mësojnë për një edukim të mirëfilltë fiskal dhe disiplinë financiare. Pavarësisht kësaj Komisioni i Tatimeve ka bërë propozimet dhe komentet e veta në takim me ATK-në me qëllim të përmirësimit të qasjes sa më të lehtë të tatimpaguesve në shërbimet elektronike EDI:

1. Nxjerrja e Gjendjes së përgjithshme (për nevoja të aplikimit për kredi etj.)
2. Forma për c 'regjistrim nga TVSH
3. Forma e Kërkesës kompensim Debi-Kredi
4. Kërkesa për hapje të llogarisë së tatimit (ËR etj)
5. Aplikimi për tatuarje në formë reale për B. I dhe Korporata
6. Kërkesë për Ndryshim të adresës së tatimpaguesit pas ndryshimit në ARBK
7. Pasqyra e Përmbledhjes vjetore e mbajtjes të tatimit në burim etj.

të gjitha ketë në mënyrë që të evitohen procedurat burokratike, madje edhe lirimi nga ndëshkimet me rastin e përmbushjes së marrëveshjeve me pagesë me këste të bëhet në mënyrë automatike pa pasur nevojë që tatimpaguesi të bëjë Kërkesë në ATK.

Kritikat e anëtarësisë së Shoqatës rreth Ngarkesës së kundërt Komisioni i Tatimeve i ka përcjell në takime me ATK-në përfshirë edhe takimin me drejtorin e përgjithshëm të ATK-së në muajin maj , ku janë shpreh kritika ndaj zyrtarëve tatimor rreth problematikës së trajtimit të Ngarkesës së kundërt në ndërtimtari dhe kontratat e ndërtimit gjatë kontrolleve dhe vizitave tjera përmbushëse. Vetë fakti që janë publikuar dhe ndryshuar një numër i konsiderueshëm i Vendimeve shpjeguese të ngarkesës së kundërt dëshmon se anëtarësia e Shoqatës sonë ka pasur arsye dhe të drejtë të reagoj.

Mbetet që SHKÇAK si faktor i rëndësishëm në këtë profesion përmes anëtarëve , komisioneve të ndryshme dhe Komisionit të Tatimeve të angazhohet dhe të ketë një rol shumë më domethënës në politikën qeveritare duke qenë një mbrojtës i interesit publik përfshirë edhe interesin ekonomik të komunitetit biznesor përmes lehtësirave të procedurave tatimore dhe atyre biznese në përgjithësi.

Fahri Breznica


Kryesues i Komisionit për Tatime

STATISTIKAT E VITIT 2019

Llojet e shërbimeve që ofrohen nga anëtarët e ShKÇAK-së

Shërbimet e auditimit, shërbimet kontabël, këshillimet për tatime, mbajtja e librave kontabël dhe role të tjera të ngjashme, janë disa nga shërbimet tipike që ofrohen prej kontabilistëve të punësuar në ekonomitë perëndimore, e që kryhen edhe nga anëtarët e ShKÇAK.

Grafiku i mëposhtëm shfaq shpërndarjen e anëtareve tanë të cilët janë profesionistë të kontabilitetit dhe auditimit nëpër sektorë të ndryshme, duke demonstruar se profesionistë të tillë janë të përfaqësuar në një gamë të gjerë të sektorëve të punës. Prandaj, ngritja e kapaciteteve në këtë profesion është e domosdoshme në mënyrë që të gjithë sektorët të operojnë me cilësi të lartë. Pikërisht kjo është çfarë motivon ShKÇAK për të krijuar programe të reja për specializim në sektorë specifikë, pra në atë privat dhe publik si dhe fusha specifike siç është auditimi i brendshëm.



PËRQINDJA E ANËTARËVE AKTIV TË PUNËSUAR NËPËR SEKTORE

Akademi/Edukim	1%
Industri/Tregti	26%
Studente	21%
Firma të kontabilitetit/auditimit	15%
Sektori Publik	12%
Tjera	25%

Rezultatet tregojnë se 26% e anëtarëve janë të punësuar në kategorinë Industri/Tregti, ndërsa 12% e tyre janë të punësuar në sektorin publik. Po ashtu, 15% e tyre janë partnerë apo punonjës në firma të auditimit dhe kontabilitetit, 21% janë studentë, dhe 25% e anëtarëve janë të angazhuar në sektorë të tjerë.


Një numër i konsiderueshëm i anëtarëve tanë janë po ashtu të përfshirë në sektorin Akademi/Edukim, përkatësisht 1% e tyre. Ky përfaqësim ndihmon në përafrimin e kurrikulumeve të kontabilitetit dhe auditimit në mes të edukimit akademik dhe profesional sipas Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit në Kontabilitet (SNEK).

STUDENTËT E REGJISTRUAR GJATË VITIT 2019

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e studentëve të ri të cilët janë regjistruar në programet çertifikuese të ShKÇAK. Gjatë vitit 2019 kemi pasur numër të madh të studentëve të cilët janë regjistruar në nivelin para kualifikues Teknik i Kontabilitetit.

Specifikisht, 163 studentë janë regjistruar në programin për nivelin kualifikues “Kontabilist i Çertifikuar”, dhe 50 studentë janë regjistruar në programin për të marrë titullin “Auditor i Brendshëm i Çertifikuar”.

NUMRI I STUDENTËVE TË RINJË SIPAS PROGRAMEVE ÇERTIFIKUESE




TITUJT E FITUAR PËRGJATË VITEVE

ShKÇAK iu jep studentëve dhe anëtarëve mundësi mjaft të mëdha për t'u treguar të suksesshëm duke ofruar tre afate të provimeve gjatë një viti. Në këtë mënyrë edhe atëherë kur studentët dhe anëtarët nuk arrijnë suksesin e dëshiruar gjatë një afati mund të përgatiten dhe të kenë mundësinë t'i nënshtrohen provimeve një apo dy afate më vonë.

Statistikat e ShKÇAK flasin për një rritje të theksuar të numrit të anëtarëve të çertifikuar nga viti 2016-2019, në të tre nivelet e çertifikimeve, ku vërehet një interesim i shtuar për pjesëmarrje në nivelin Teknik të Kontabilitetit, Kontabilist të Çertifikuar dhe Auditorë të Çertifikuar.


ANËTARËT AKTIV QË KANË FITUAR TITULLIN PËRKATËS



PJESËMARRJA NË PROFESION SIPAS GJINISË

Tradicionalisht, profesioni i kontabilitetit dhe auditimit ka qenë i përfaqësuar nga gjinia mashkullore si në botë ashtu edhe në vend. Megjithatë, në kohët e fundit ka pasur një ndryshim për të mirë në këtë drejtim pasi që ka vazhduar të rritet numri i ushtrueseve femra të këtij profesioni. Kjo e përforcon faktin që femrat në Kosovë po emancipohen dita ditës më shumë.

Grafiku i mëposhtëm tregon se gjatë vitit 2019, përqindja e anëtareve femra të Shoqatës ka qenë 53%, ndërsa e anëtarëve meshkuj ka qenë 47%. Kështu, krahasuar me vitin 2002 ku pjesëmarrja e femrave si anëtare të shoqatës ka qenë vetëm 14%, viti 2019 vazhdon të shënoj rritje drastike me pjesëmarrje të femrave.




FEMRA
MESHKUJ

INTERESIMI I TË RINJVE PËR PROFESIONIN

Përfaqësimi i anëtarëve aktiv të ShKÇAK sipas moshës është i paraqitur në grafikun e mëposhtëm ku krahasojmë vitet 2016 -2019.

Në kategorinë nën 25 34 vjeç, përqindja e anëtarëve është rritur nga 70% në 83%. Kjo nënkupton se të rinjtë në Kosovë janë të interesuar të kualifikohen çdo herë e më shumë në kontabilitet dhe auditim duke marrë parasysh përfitimet që profilizimi në një fushë specifike sjell.

Gjithashtu edhe në kategorinë e moshave 35 -54 vjeç vërejmë rritje të dukshme, përfaqësimi është mjaft i madh dhe dallimi në mes të anëtarëve aktivë të këtyre grup moshave për vitet e cekura.



**PASQYRAT FINANCIARE DHE
RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR
31 DHJETOR 2019**



**Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar
dhe Auditorëve të Kosovës**

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve
të pavarur 31 Dhjetor 2019**



Përmbajtja:

Raporti i auditorëve të pavarur	3
Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse	5
Pasqyra e pozitës financiare	6
Pasqyra e ndryshimeve në fonde	7
Pasqyra e rrjedhës së parashë	8
Shënimet e pasqyrave financiare	9-22

Raport i Auditorit të Pavarur

Drejtuar: Këshillit të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të **Shoqatës së kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës** më 31 Dhjetor 2019, dhe rezultatin e aktivitetit të saj për fundin e vitit, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Shoqatës së kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës**, të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2019, si dhe Pasqyrën e të Ardhurave, Pasqyrën e Ndryshimeve në Fonde, Pasqyrën e Rrjedhjes së Parasë për vitin e përmbyllur dhe të shënimeve tjera shpjeguese.

BazapërOpinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Kompaninë apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.

- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Kompanisë.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Astut Musa

ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
Shkurt 2020



PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE


(në Euro)
Për vitin që përfundon më 31 dhjetor

	Shënimet	2019	2018
Të hyrat operative			
Të hyrat nga edukimi	3	304,678	292,726
Të hyrat nga anëtarësimi	3	102,878	99,345
Të hyrat tjera	3	7,800	7,999
Të hyrat nga kontrolli i cilësisë	3	13,000	6,400
Totali i të hyrave		428,356	406,470
Shpenzimet			
Shpenzimet administrative	4	162,896	165,413
Shpenzimet e trajnimit	5	126,775	138,494
Shpenzimet e provimeve	6	23,631	19,529
Shërbimi për anëtarë	7	112,789	124,669
Totali i shpenzimeve		426,091	448,104
Teprica / (Mungesa) e të hyrave për vitin		2,265	(41,634)

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i SHKÇAK më 26 mars 2020 dhe janë nënshkruar nga:


Driton Pustina

Kontabilist i Çertifikuar



Afërdita Gashi

Kryetare e këshillit



PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

		(në Euro)	(në Euro)
	Shënimet	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	11	29,524	33,896
Pasuritë e paprekshme	12	14,289	23,339
		43,813	57,235
Pasuritë qarukulluese			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	450,487	415,740
Parapagimet	9	9,063	8,839
Të arkëtueshmet	10	14,145	4,647
Stoqet - librat		3,213	3,698
		476,909	432,925
Totali i pasurive		520,722	490,159
Detyrimet afat-gjata			
Kredia afatgjatë		10,268	17,791
		10,268	17,791
Detyrimet afat-shkurta			
Detyrimet tregtare dhe të tjera	13	13,714	14,372
Kredia afatshkurtër		7,522	7,375
Avanset nga anëtarët		-	1,095
Të hyrat e shtyra	14	134,019	96,593
		155,256	119,434
Fondet			
Teprica e akumuluar e të hyrave		355,198	352,933
		355,198	352,933
Totali i detyrimeve dhe fondeve		520,722	490,159

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE FONDE**Pasqyra e Ndryshimeve në Fonde**

	(në Euro)	
	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Më 01 janar	352,933	394,560
Ndryshime të tjera në tepricën e akumuluar	-	9
Mungesa e të hyrave për vitin	2,265	(41,634)
Teprica e akumuluar e të hyrave më 31 dhjetor	355,198	352,933

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

		(në Euro)	
		Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	
	Shënimet	2019	2018
AKTIVITETET OPERATIVE			
Mungesa e të hyrave e vitit		2,265	(41,634)
Zhvlërësimi dhe amortizimi	12, 13	16,120	15,612
Teprica nga largimi i pasurive	12	-	(4,500)
Mungesa nga largimi i pasurive	12	-	183
Të arkëtueshmet	10	(9,498)	(921)
Parapagimet		(224)	(3,210)
Stoqet - librat		485	477
Detyrimet tregtare dhe të tjera		(1,753)	4,879
Të hyrat e shtyra		37,426	2,916
Ndryshime të tjera në tepricën e akumuluar		-	9
Paraja neto nga aktivitetet operative		44,821	(26,189)
AKTIVITETET INVESTUESE			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve		(2,698)	(34,714)
Shitja e pronës, impianteve dhe pajisjeve		-	4,500
Pasuritë e paprekshme		-	(2,481)
Paraja neto nga aktivitetet investuese		(2,698)	(32,694)
AKTIVITETET FINANCUESE			
Kredia		(7,375)	25,166
Paraja neto nga aktivitetet financuese		(7,375)	25,166
Rrjedha neto e parasë për periudhën		(34,749)	(33,717)
Gjendja e parasë në fillim		415,740	449,459
Gjendja e parasë në fund	8	450,487	415,740

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

1. Të përgjithshme

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (“SHKÇAK” ose “Organizata”) është organizatë jo profitabile e themeluar në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/22 dhe Ligji Nr.06/L- 043 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare. SHKÇAK është themeluar për qëllim të:

- Profesionalizmit të Ndërsjelltë: për të përkrahur, mbrojtur dhe avancuar karakterin, statusin dhe interesat e profesionit të kontabilitetit në përgjithësi dhe të kontabilistëve e auditorëve në veçanti që janë anëtarë të SHKÇAK;
- Rritjes Profesionale: që të lehtësojë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kompetencave të anëtarëve përgjatë karrierës së tyre;
- Integritetit: për të mbajtur nivelin më të lartë të standardeve profesionale dhe integritetit të anëtarëve në interes të komunitetit; dhe
- Përfaqësimit: për të përfaqësuar profesionin në komunitet.

Me 31 dhjetor 2019 dhe 2018, Organizata ka kryer aktivitetet me 14 dhe 17 të punësuar përkatësisht.

2 Politikat e kontabilitetit

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet e Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Pasqyrat Financiare janë përgatitur për vitet e perfunduara me 31 dhjetor 2019 dhe 2018. Të dhënat aktuale dhe krahasuese në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Euro, përderisa nuk ceket ndryshe. Kur është e nevojshme zërat krahasues janë harmonizuar konform ndryshimeve të vitit në prezantim.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2019. Të dhënat aktuale dhe krahasuese të paraqitura në këto pasqyra financiare janë shprehur në Euro.

2.2 Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

2.3 Zbatimi i standardeve të reja dhe të ndryshuara

Në vitin aktual, Organizata ka zbatuar një numër të ndryshimeve në SNRF të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) që janë të obligueshme dhe efektive për periudhën që fillon me ose pas datës 1 janar 2018.

SNRF 9 Instrumentet financiare

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime domethënëse në udhëzimet e SNK 39 për riklasifikimin dhe matjen e pasurive financiare dhe paraqet modelin e ri të „humbjes së pritur kreditore“ për dëmtimin e pasurive financiare. SNRF 9 po ashtu ofron ushëzime të reja mbi zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Menaxhmenti ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9 por nuk është ende në pozitë të ofrojnë informata të kuantifikuara.

SNRF 9 është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me konsumatorët

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të hyrave, duke zëvendësuar SNK 18 „Të hyrat“, SNK 11 „Kontratat ndërtimore“ dhe disa interpretime që lidhen me të hyrat. Parimi themelor i SNRF 15 është që

entiteti duhet të njoh të hyrat ashtu që ilustron transferin e mallrave ose shërbimeve të premtuara te konsumatorët në shumën që reflekton konsideratën për të cilën entiteti ka të drejtën si shkëmbim për ato mallra ose shërbime.

SNRF 15 është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018.

SNRF 16 Lizingu

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretime përkatëse. SNRF 16 paraqet model gjithëpërfshirës për identifikimin e arranzhimeve për lizing dhe trajtimin kontabël për qiradhënësit dhe qiramarrësit. SNRF 16 bën dallimin në mes të kontratave për shërbime duke u bazuar në faktin nëse një pasuri e identifikuar kontrollohet nga konsumatori. Dallimet në mes të lizingut operativ (jashtë bilancit) dhe lizingut financiar (në bilanc) janë hequr për kontabilitetin e qiramarrësit dhe është zëvendësuar me modelin sipas të cilit e drejta e përdorimit të pasurisë dhe detyrimi korrespondues duhet të njihen për të gjitha lizingjet nga qiramarrësi (dmth të gjitha në bilanc) përveç për lizingjet afatshkurta dhe lizingjet për pasuritë me vlerë të ulët.

SNRF është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019. Menaxhmenti ende pritet të vlerësojë në tërësi ndikimin e këtij standardi prandaj nuk është në gjendje të ofroj informata të kuantifikuara.

2.4 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

2.5 Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

2.6 Kundërbalancimi (offsetting)

Pasuritë financiare dhe detyrimet janë kundërbalancuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes atëherë kur ka të drejtë të imponueshme ligjore për të kundërbalancuar shumat e njohura dhe ka synim të vendoset në baza neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

2.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Organizatë dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

Organizata njih të ardhurat duke i ngarkuar llojet në vazhdim:

- Tarifat e anëtarisë dhe tarifat e edukimit janë njohur fillimisht kur është lëshuar faktura. Të hyrat janë rregulluar në fund të vitit për të reflektuar vetëm të hyrat e fituara gjatë vitit.
- Të hyrat nga tarifat e edukimit dhe anëtarimit janë shtyrë për pagesat e pranuar për paradhënie.

2.8 Prona, impiantet dhe paisjet

Prona, impiantet dhe paisjet janë bartur në kosto historike minus zhvlersimi i akumuluar. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Zhvlersimi është ngarkuar duke përdorur metodën lineare në normat e paracaktuara në mënyrë që të alokohet kostoja e pronës, impianteve dhe paisjeve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

Në vazhdim është paraqitur jeta e përafërt e përdorimit e aplikuar ndaj zërave të rëndësishëm të pronës, impianteve dhe paisjeve:

2.9 Prona, impiantet dhe paisjet (vazhdim)

	2019	2018
Mobiljet dhe paisjet	2-5 vite	2-5 vite
Paisjet e TI nën 1,000 Euro	3 vite	3 vite
Veturat	5 vite	5 vite

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurive ose janë njohur si pasuri të ndara, si ka qenë e përshtatshme, vetëm kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Organizatë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Fitimet dhe humbjet mbi heqjet janë përcaktuar duke krahasuar shumat me vlerat bartëse. Këto janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

2.10 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetëgjatësi të caktuar të cilat janë blerë veç e veç mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet në baza të njejtë përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë.

Pasuritë e pa prekshme të Organizatës përbajnë Softuerë kompjuterik, të drejtat autoriale për

shfrytëzimin e librave dhe licence nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) Gjithashtu këto pasuri përfshijnë koston e përkthimit të librave të programit të auditimit të brendshëm e cila është kapitalizuar si kosto e zhvillimit në pajtueshmëri me SNK 38 Pasuritë e paprekshme.

Amortizimi është ngarkuar duke përdorur metodën drejtvizore brenda pesë viteve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

2.11 Dëmtimi i pasurive të prekshme dhe të paprekshme

Në fund të secilës periudhë raportuese, Organizata rishikon shumat bartëse të pasurive të prekshme dhe të pa prekshme të saj për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dëshmi që ato pasuri kanë humbje nga dëmtimi. Nëse ekziston ndonjë informacion i tillë, shumata e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet masa e humbjeve nga dëmtimi (nëse ka).

Shumata e rikuperueshme është më e lartë se sa vlera e drejtë minus shpenzimet e hujes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës së përdorimit, rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme janë të skontuara në vlerën e tyre të tanishme duke përdorur normën e skontimit të para-tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe riskun specifik të pasurisë për të cilën vlerësimet e rrjedheve të ardhshme të parasë nuk kanë qenë të rregulluara.

Nëse shumata e rikuperueshme e një pasurie vlerësohet të jetë më e vogël se vlera bartëse e saj, vlera bartëse e pasurisë zvogëlohet në shumën e rikuperueshme të saj. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim apo humbje, përveç rastit kur pasuria përkatëse mbahet me shumën e rivlerësuar, ku në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si rënje e rivlerësimit. Pasuritë që janë subjekt i amortizimit janë rishikuar për dëmtim kurdo që ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos rikuperohet. Vlera bartëse e një pasurie është shënuar menjëherë në vlerë të rikuperueshme nëse vlera bartëse e një pasurie është më e lartë se vlera e rikuperueshme që është vlerësuar të jetë. Vlera e rikuperueshme është më e larta e vlerës reale të pasurisë minus kosto e shitjes dhe vlerës në përdorim.

2.12 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njeh si shpenzime koston përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktiv apo të i njeh pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me koston, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.13 Instrumentet Financiare

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Organizata bëhet pjesë e marrëveshjeve kontraktuale të instrumenteve.

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e tyre të drejtë. Kostot e transaksioneve të cilat i atribuohen direkt blerjes apo emetimit të pasurive financiare dhe detyrimeve

financiare u shtohen apo i zbriten vlerës së drejtë të pasurive financiare apo detyrimeve financiare, në mënyrë të përshtatshme në njohjen fillestare. Kostot e transaksioneve të atribueshme direkt blerjes së pasurive financiare apo detyrimeve financiare në vlerën e tyre të drejtë përmes fitimit apo humbjes njihen menjëherë në fitim apo humbje.

Pasuritë financiare

Pasuritë financiare klasifikohen në kategoritë specifike siç janë: pasuritë financiare „në vlerën e drejtë

përmes fitimit dhe humbjes" (VDPFH), investimet „e mbajtura deri në maturim“ , pasuritë financiare „të gatshme-për-shitje“ (GPSH) dhe „huatë dhe të arkëtueshmet“ . Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i pasurive financiare dhe përcaktohet në kohën e njohjes fillestare. Të gjitha blerjet apo shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në bazë të datës së tregtimit. Blerjet apo shitjet në mënyrën e rregullt janë blerjet apo shitjet e pasurive financiare të cilat kërkojnë shpërndarjen e pasurive brenda kohës së caktuar nga rregullimi apo marrëveshja në treg.

Metoda efektive e interesit

Metoda efektive e interesit është metoda e kalkulimit të kostos së amortizuar të një instrumenti të borxhit dhe të alokimit të të hyrave nga interesi përgjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit e cila saktësisht skanton arkëtimet e ardhshme të parasë, të vlerësuar përmes jetës së pritit të instrumentit të borxhit, apo, ku është e përshtatshme, një periudhe më të shkurtër, vlerës neto bartëse në njohjen fillestare.

Të hyrat njihen në baza të interesit efektiv për instrumentet e borxhit, të ndryshme nga ato të cilat klasifikohen si VDPFH.

Pasuritë financiare të VDPFH

Pasuritë financiare klasifikohen si VDPFH kur pasuria financiare është (i) konsideratë kontigjente e cila mund të paguhet nga një blerje si pjesë e kombinimit të biznesit për të cilën aplikohet SNRF 3, (ii) të mbajtura për tregtim, ose (iii) janë të përcaktuara si VDPFH.

Investimet e mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë pasuri financiare jo-derivate me pagesa fikse apo të përcaktueshme dhe data fikse të maturimit, ku Organizata ka qëllim pozitiv dhe mundësi të i mbaj deri në maturim. Pas njohjes fillestare, investimet e mbajtura deri në maturim vlerësohen sipas kostos së amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit minus çfarëdo dëmtimi.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë pasuri financiare jo-derivate me pagesa fikse apo të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në tregun aktiv. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme (duke përfshirë të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera, paranë e gatshme dhe paranë në bankë) vlerësohen sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, minus çfarëdo dëmtimi.

Pasuritë financiare të gatshme-për-shitje (pasuritë financiare GPSH)

Pasuritë financiare GPSH janë jo-derivate të cilat janë të përcaktuara sikur GPSH apo nuk klasifikohen si (a) huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, (b) investimet që mbahen deri në maturim apo (c) pasuritë financiare në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes

Dëmtimi i pasurive financiare

Pasuritë financiare, të ndryshme nga VDPFH, vlerësohen si indikatorë të dëmtimit në fund të secilës periudhë raportuese. Pasuritë financiare konsiderohen të dëmtuara kur ka dëshmi që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që ndodhin pas njohjes fillestare të pasurive financiare, janë ndikuar rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme të vlerësuara të investimeve.

Për instrumentet e ekuitetit GPSH, një rënje domethënëse apo e zgjatur në vlerën e drejtë të letrës me vlerë poshtë kostos së tij konsiderohet të jetë dëshmi e dëmtimit.

Për të gjitha pasuritë e tjera financiare, dëshmi të vlefshme të dëmtimit mund të përfshijnë:

- Vështirësitë financiare domethënëse të emtuesit apo të palës tjetër;
- Prishja e kontratës, siç është mospagesa apo shkelja në pagesat e interesit apo kryegjësë;
- Mundësia që huamarrësi të ketë falimentim apo ri-organizim financiar; apo
- Humbja e një tregu aktiv për pasuritë financiare për shkak të vështirësive financiare.

Për disa kategori të pasurive financiare, siç janë llogaritë e arkëtueshme tregtare, pasuritë vlerësohen për dëmtim në baza kolektive edhe nëse individualisht nuk janë vlerësuar për dëmtim. Dëshmitë e vlefshme të dëmtimit për një portfolio të llogarive të arkëtueshme mund të përfshijnë përvojën e kaluar të mbledhjes së pagesave të Organizatës, një rritje në numrin e pagesa të vonuara në portfolio, si dhe ndryshimet e dukshme në kushtet ekonomike kombëtare apo lokale të cilat lidhen me mospagesën e llogarive të arkëtueshme.

Për pasuritë financiare të cilat vlerësohen sipas kostos së amortizimit, shuma e njohur e humbjeve nga dëmtimi është diferenca në mes të shumës bartëse të pasurisë në vlerën e tanishme dhe vlerës së tanishme të rrjedhës së parasë, e skontuar në normën efektive origjinale të pasurisë financiare.

Për pasuritë financiare që vlerësohen sipas kostos së amortizuar, nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga dëmtimi bie, dhe rënja mund të jetë e lidhur objektivisht me një ngjarje që ndodhë pas njohjes së dëmtimit, humbja nga dëmtimi i njohur në fillim kthehet mbrapsht përmes fitimit apo humbjes deri në masën që shuma e bartur e investimit në datën e dëmtimit të kthyer mbrapsht nuk e tejkalon shumën e kostos së amortizuar që do të kishte qenë nëse dëmtimi nuk do të ishte njohur.

Çnjohja e pasurive financiare

Organizata e çnjeh pasurinë financiare kur të drejtat kontraktuale të rrjedhës së parasë për largimin e pasurive, apo transferimin e pasurisë financiare dhe kryesisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë së pasurisë i kalojnë palës tjetër.

Në çnjohje të plotë të pasurisë financiar, diferenca në mes të shumës bartëse të pasurisë dhe shumës së konsideratës së pranuar dhe llogarive të arkëtueshme dhe humbjet apo fitimet kumulative që ishin njohur në pasqyrën tjetër gjithëpërfshirëse dhe të akumuluar në ekuitet njihet në fitim apo humbje.

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime financiare „VDPFH” apo „detyrime financiare të tjera”

Detyrimet financiare VDPFH

Detyrimet financiare klasifikohen si VDPFH kur detyrimi financiar është (i) konsiderata kontigjente e cila mund të paguhet në blerje si pjesë e kombinimit biznesor për të cilën aplikohet SNRF 3, (ii) të mbajtura për tregtim, apo (iii) është e përcaktuar si VDPFH.

Detyrimet financiare të tjera

Detyrimet financiare të tjera (përfshirë huazimet dhe të pagueshmet tregtare dhe të tjera) janë më pas të vlerësuara me koston së amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit.

Çnjohja e detyrimeve financiare

Organizata i çnjeh detyrimet financiare kur, dhe vetëm kur obligimet e Organizatës shkarohen, anulohen apo shuhen. Diferenca në mes të shumës bartëse të detyrimit financiar të çnjohur dhe konsiderata e paguar dhe të pagueshmet njihen tek fitimi dhe humbja.

2.14 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur.

2.15 Benefitet e të punësuarve

Organizata kontribon në planet pas pensionale të të punësuarve të saj siç përshkruhen nga legjislacioni i sigurimit i miratuar nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Kontributet, e bazuara në paga, u janë bërë organizatës nacionale që janë përgjegjëse për pagesën e pensioneve. Nuk ka detyrim shtesë në lidhje me këto plane dhe kështu këto skema janë konsideruar si plane të definuara të kontributeve. Organizata nuk ka benefite pas pensionale ndaj të punësuarve të saj.

2.16 Tatimi në fitim

SHKÇAK është krijuar si organizatë jo profitabile dhe prandaj, është e liruar nga tatimi në të ardhura të korporatave. SHKÇAK gjatë vitit 2019 nuk ka gjeneruar të hyra tjera nga aktivitetet ekonomike të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave.

Organizata nuk ka njohur ndonjë detyrim apo pasuri të shtyrë tatimor me 31 Dhjetor 2019, siç nuk ka ndryshime të përkohshme ekzistuese në ato data.

2.17 Menaxhimi i riskut financiar

Risku kreditor

Risku kreditor paraqet riskun që pala tjetër të dështoj në kryerjen e obligimeve kontraktuale që rezulton në humbje financiare të Organizatës. Organizata ka adoptuar një politikë për të kontraktuar vetëm palët e besueshme dhe të siguroj dëshmi të mjaftueshme, për të zvogëluar rrezikun e humbjes financiare nga dështimi në kryerjen e pagesave. Organizata siguron që një vetëm të arkëtueshmet nga individët e organizatave të mirë-formuara në Kosovë. Ekspozimi ndaj kredive kontrollohet në baza periodike nga Zyrtari Ekzekutiv dhe Këshilli.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i cili ndryshon me ndryshimin e çmimeve të tregut, siç janë ndryshimi i kursit valuator i jashtëm dhe i normave të interesit që do të ndikojnë në të hyrat e Organizatës apo vlerën e zotërimeve të instrumenteve financiare të saj. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregut është menaxhimi dhe kontrollimi i ekspozimit të riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, gjatë optimizimit të kthimit. Përderisa nuk ka transaksione materiale në valutën e huaj dhe përderisa nuk ka interes në fondet e huazuara nga institucionet financiare lokale dhe të jashtme në datën e pozicionit financiar, Organizata nuk ekspozohet ndaj çfarëdo ndryshimi të kursit të këmbimit dhe rrezikut të normave të interesit.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Pasuritë		
Paraja e gatshme dhe në bankë	450,487	415,740
Totali	450,487	415,740

Risku i likuiditetit

Përgjegjësia themelore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit i takon Këshillit të ShKÇAK. Menaxhimi i matur i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parasë së gatshme, disponueshmëri të fondeve përmes lehtësirave për kredi dhe mundësisë për t' i mbledhur në kohën e duhur, brenda kushteve

të shumave të vendosura për shkak të konsumatorëve. Organizata menaxhon riskun e likuiditetit duke mbajtur rezerva të mjaftueshme, lehtësira bankare dhe duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme planifikimin dhe rrjedhën aktuale të parasë, dhe duke koordinuar profilet e maturitetit të pasurive dhe detyrimeve financiare.

Tabelat në vijim paraqesin maturitetet kontraktuale të mbetura të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të Organizatës. Tabelat përgatiten në baza të rrjedhave të parasë të paskontuara të detyrimeve financiare.

	31 Dhjetor 2019			
	Qarkulluese	Jo - qarkulluese		
	Deri në 1 vit (Euro)	1 deri 2 vite (Euro)	2 deri 5 vite (Euro)	Mbi 5 vite (Euro)
Pasuritë financiare				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	450,487	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme	14,145	-	-	-
Totali i pasurisë	464,632	-	-	-
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	13,714			-
Totali i detyrimeve financiare	13,714			-
	31 Dhjetor 2018			
	Qarkulluese	Jo - qarkulluese		
	Deri në 1 vit (Euro)	1 deri 2 vite (Euro)	2 deri 5 vite (Euro)	Mbi 5 vite (Euro)
Pasuritë financiare				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	415,740	-	-	-
Llogaritë e arkëtueshme	4,647	-	-	-
Totali i pasurive financiare	420,387	-	-	-
Detyrimet financiare				
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	14,372			-
Totali i detyrimeve financiare	14,372			-

Instrumentet financiare që nuk paraqiten në vlerën e drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe vlerat e drejta të pasurive dhe detyrimeve financiare që nuk paraqiten në Pasqyrën e pozitës financiare në vlerën e tyre të drejtë:

	Vlera bartëse		Vlera e drejtë	
	2019	2019	2018	2018
Pasuritë financiare				
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	450,487	450,487	415,740	415,740
Llogaritë e arkëtueshme	14,145	14,145	4,647	4,647
Totali i pasurive financiare	464,632	464,632	420,387	420,387

Detyrimet financiare

Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera

	13,714	13,714	14,372	14,372
Totali i detyrimeve financiare	13,714	13,714	14,372	14,372

2.18 Ngjarjet pasuese

Ngjarjet pas përfundimit të vitit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin e Organizatës në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarje pas përfundimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në pasqyra financiare kur kanë qenë materiale.

3 Të hyrat

	2019	2018
Të hyrat nga edukimi		
Regjistrimi	7,420	5,330
Trajnimet - Sektori privat	138,490	139,890
Provimet - Sektori privat	72,370	66,960
Provimet - Sektori publik	950	1,250
Trajnimit - Auditim i Brendshëm	23,290	12,240
Provimet - Auditim i Brendshëm	6,500	8,250
Trajnimet për specializimet - Ekspert i Lartë Tatimor dhe Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare	8,150	4,980
Trajnimet - Forenzika (UNDP)	-	19,800
Trajnimet - Ekspert Tatimor (GIZ dhe Ambasada Britanike)	20,000	15,000
Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	27,508	19,026
Gjithsej të hyrat nga edukimi	304,678	292,726
Të hyrat nga anëtarësimi	102,878	99,345
Të hyrat tjera	7,800	7,999
Të hyrat nga Kontrolli i Cilësisë	13,000	6,400
Gjithsej të hyrat	428,356	406,470

4 Shpenzimet administrative

	2019	2018
Pagat	112,159	107,639
Zhvlërësimi (Shënimi 11)	7,070	6,562
Amortizimi (Shënimi 12)	9,050	9,050
Qiraja	10,800	10,800
Shërbimet komunale	2,379	2,418
Shpenzime të komunikimit	2,075	2,936
Furnizime të zyrës	2,507	2,771
Auditimi	3,050	3,227
Mirëmbajtje - Renovimi i zyrës	579	7,974
Sigurimi shëndetësor	5,050	4,452
Shpenzimet e reprezentacionit	5,174	2,676
Shpenzimet e automjetit	2,009	3,047
Zhvillimi i personelit	994	32
Borxhet e këqija	-	1,829
	162,896	165,413

5 Shpenzimet e trajnimit

Shpenzimet e trajnimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 ishin si në vazhdim:

	2019	2018
Mbajtja e trajnimeve	57,663	70,617
Qiraja	22,800	19,800
Printimi	6,420	7,362
Spektori publik	15,743	18,680
Shpenzimet e rrymës	2,304	2,184
Të drejtat autoriale nga BPP, përkthimi dhe azhurnimi	7,442	15,171
Spektori i auditimit të brendshëm	7,347	2,672
Trajnimet Ekspert Tatimor (GIZ dhe Ambasada Britanike)	7,056	-
Tjera	-	2,009
	126,775	138,494

6 Shpenzimet e provimeve

	2019	2018
Përpilimi, korigjimi	13,740	9,528
Mbikëqyrja	5,527	5,573
Qiraja	2,160	2,160
Printimi	2,187	2,243
Tjera	17	25
	23,631	19,529

7 Shërbimi për anëtarë

	2019	2018
Edukimi i vazhdueshëm profesional	6,608	9,336
Këshilli dhe Komisionet	7,560	6,227
Udhëtimet	21,563	21,292
Takimet vjetore dhe ceremonitë	8,328	8,657
Anëtarësia në organizata	16,058	14,557
Seminare dhe punëtori	-	4,992
Pagat - shërbimi për anëtarë	25,328	26,269
Zhvillim i çertifikimeve tjera dhe KC	22,354	28,440
Marketingu	1,615	1,955
IT dhe Web-faqja	3,377	2,945
	112,789	124,669

8 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	2019	2018
Llogari rrjedhëse - Pro Credit Bank	37,998	80,696
Llogari rrjedhëse - Banka Private e Biznesit	162,439	84,994
Llogari rrjedhëse - Banka Private e Biznesit USD	49	49
Depozitat afatshkurtëra të afatizuara	250,000	250,000
	450,487	415,740

9	Parapagimet	2019	2018
	Parapagimet	9,063	8,839
		9,063	8,839
10	Të arkëtueshmet	2019	2018
	Të arkëtueshmet nga anëtarët	14,412	5,164
	Minus: Lejimi për borxhet e dyshimta nga anëtarët	(516)	(516)
	Të arkëtueshmet e tjera	250	-
		14,145	4,647
11	Prona, impiantet dhe paisjet		
		Kompjuterët dhe pajisjet tjera	Automjeti
			Totali
	KOSTO		
	Më 01 janar 2018	66,958	12,666
	Shtesat gjatë vitit 2018	5,014	29,700
	Heqjet gjatë vitit 2018	(1,239)	(12,666)
	Më 31 dhjetor 2018	70,733	29,700
	Më 01 janar 2019	70,733	29,700
	Shtesat gjatë vitit 2019	2,698	-
	Më 31 dhjetor 2019	73,431	29,700
	Zhvlerësimi i akumuluar		
	Më 01 janar 2018	(61,031)	(12,666)
	Zhvlerësimi i vitit 2018	(3,592)	(2,970)
	Zhvlerësimi për heqjet gjatë vitit 2018	1,055	12,666
	Më 31 dhjetor 2018	(63,567)	(2,970)
	Më 01 janar 2019	(63,567)	(2,970)
	Zhvlerësimi i vitit 2019	(4,100)	(2,970)
	Më 31 dhjetor 2019	(67,667)	(5,940)
	Vlera neto në libra		
	Më 31 dhjetor 2018	7,166	26,730
	Më 31 dhjetor 2019	5,764	23,760

12 Pasuritë e patrupëzuara

	Softuerë kompjuterik	Të drejtat autoriale për shfrytëzimin e librave	Licenca nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	Totali
KOSTO				
Më 01 janar 2018	42,326	32,275	4,586	79,187
Shtesat gjatë vitit 2018	139	-	2,342	2,481
Më 31 dhjetor 2018	42,465	32,275	6,928	81,668
Më 01 janar 2019	42,465	32,275	6,928	81,668
Shtesat gjatë vitit 2019	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2019	42,465	32,275	6,928	81,668
Amortizimi i akumuluar				
Më 01 janar 2018	(41,296)	(6,455)	(1,529)	(49,279)
Amortizimi i vitit 2018	(285)	(6,455)	(2,309)	(9,050)
Më 31 dhjetor 2018	(41,581)	(12,910)	(3,838)	(58,329)
Më 01 janar 2019	(41,581)	(12,910)	(3,838)	(58,329)
Amortizimi i vitit 2019	(285)	(6,455)	(2,309)	(9,050)
Më 31 dhjetor 2019	(41,866)	(19,365)	(6,147)	(67,379)
Vlera neto në libra				
Më 31 dhjetor 2018	884	19,365	3,090	23,339
Më 31 dhjetor 2019	598	12,910	781	14,289

13 Detyrimet tregtare dhe të tjera

	2019	2018
Detyrimet për kontributin e tatimit të të ardhurave personale mbi pagat	7,743	8,122
Detyrimet për shërbimet e auditimit	3,050	3,927
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	2,624	1,969
Të pagueshme ndaj punonjësve	298	353
	13,714	14,372

14 Të hyrat e shtyra

Analiza e balancës

Me 31 Dhjetor 2019, balanca e të hyrave të shtyra përbëhet si në vazhdim:

	2019	2018
Të hyrat e shtyra të trajnimit dhe provimeve	134,019	96,593
	134,019	96,593

15 Zotimet dhe Kontingjentet

Zotimet

Nuk ka zotime më 31 Dhjetor 2019 përveç marrëveshjes së qirasë së zyrës dhe sallave të trajnimit. Pagesa mujore e qirasë për zyre dhe salla të trajnimeve është 2,800 Euro.

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2019 nuk është llogaritur asnjë provizion për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Organizatës, rregullisht analizon rreziqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjyqësore dhe pretendimet e mundshme kundër Organizatës, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Organizatës beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

